



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 24 MARS 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 24. MARTA 2016. GODINE**

**MARS - MART
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të Skemës së Ndihmës Sociale për periudhën 2013-2015,
8. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit,
10. Emërimi i një (1) anëtarit të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Formiranje Nezavisnog izbornog organa za izbor članova Organa za razmatranje javnih nabavki,
5. Prvo razmatranje N/zakona o zaštiti od buke
6. Drugo razmatranje N/zakona o upravljanju zaplenjenom i konfiskovanim imovinom
7. Razmatranje izveštaja Komisije za zdravstvo, rad i socijalna pitanja u vezi budžetskog nadgledanja šeme socijalne pomoći za period 2013 -2015
8. Razmatranje izveštaja o radu Kosovske agencije za privatizaciju za 2014 godinu,
9. Razmatranje izveštaja Komisije za prava i interese zajednica i povratak u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o selu Velika Hoča i Zakonu o Istorijskom centru Prizrena,
10. Imenovanje jednog (1) člana Borda Nezavisne komisije za rudnike i minerale.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të filloj me rendin e ditës, më lejoni të theksoj se sot është dita e 24 marsit vit historike kur para 17 vjetëve aleanca verioatlantike ka sulmuar caqet ushtarake serbe të cilat deri më atëherë po kryenin masakra mbi popullin shqiptar. Shprehim falënderimin tonë më të sinqertë në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës për aleancën verioatlantike.

Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh situatën të cilën po e kalojmë kohët e fundit shprehim edhe solidarizimin tonë me vendet që po goditen nga sulmet terroriste.

Ngushëllimin për familjet e tyre dhe përkrahje të fuqishme edhe të Kosovës se do të jetë e vendosur në çdo veprim, kundër çdo fenomeni i cili e cenon jetën e qytetarëve të lirë çdo veprimi, i cili e dëmton njeriun e lirë.

Po për këtë çështje edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, e ka kërkuar një fjalë rasti. Faleminderit!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë dëshiroj që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ta shfrytëzoj këtë seancë sot të Kuvendit në mënyrë që të shpreh keqardhjen tonë të shprehim dhimbjen për të gjitha viktimat që ndodhën në Bruksel si pasojë e veprimeve terroriste. Të shpreh po ashtu interesimin tonë dhe angazhimin tonë që të jemi pjesë e aleancës globale kundër terrorizmit, kundër radikalizmit dhe kundër të gjitha ekstremizmave që çojnë në veprime të dhunshme si pasojë e të cilave kemi humbje të jetës së njerëzve dhe kemi rrezikim demokracisë dhe të paqes në botë.

Kosova ka treguar përkushtimin e saj që ta ruajë paqen, përkushtimin e saj që të jetë pjesë e luftës kundër çdo veprimi të keq, përkushtimin e saj që të ndërtojë marrëdhënie të mira ndëretnike dhe marrëdhënie të mira ndërfetare dhe unë i ftoj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që të jemi bashkërisht pjesë e këtij përkushtimi. Ftoj po ashtu të gjithë qytetarët tanë të cilët janë në numër shumë të vogël, por të cilët eventualisht mund të jenë në fronte të luftës që ata të dalin nga këto fronte, që të jenë të vetëdijshëm për dëmin që ia shkaktojnë vetvetes që i shkaktojnë viktimave atje, por edhe për dëmin që mund të ketë edhe vendi ynë nga veprimet e tilla të dhunshme.

Unë ju siguroj se organet e sigurisë së Republikës së Kosovës, sikur Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia Kosovare e Inteligjencës po i marrin të gjitha masat në mënyrë që ta shtojnë sigurinë në vend, qytetarët tanë janë të sigurt, por po ashtu kërkoj bashkëpunim të të gjithë qytetarëve tanë në mënyrë që ta shtojmë sigurinë në vend dhe të jemi pjesë e sigurisë evropiane dhe pjesë e sigurisë globale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

I ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që për nderë të viktimave të sulmeve të terrorizmit të mbajmë një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Nderim!

Shpresojmë se edhe kolegët tanë të opozitës me të cilët kemi ndoshta për procese politike mospajtime, janë plotësisht të qëndrimit tonë të përbashkët, janë gjithsesi në luftën kundër terrorizmit dhe në përkrahjen e caqeve të NATO-s dhe i ftojmë që të jenë të pranishëm këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Xhevahire Izmaqu, nga Partia Demokratike e Kosovës.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar për mundësinë!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema ime sot ka të bëjë me çështjen e Fabrikës “Llamkos” në Vushtrri.

Zanafilla e problemeve dhe e vështirësive në Fabrikën e llamarinës “Llamkos” në Vushtrri dhe kësisoj edhe e 470 të punësuarve ka filluar në mesin e vitit 2014, kur ishte ndërprerë prodhimi në fabrikë. Ndërkohë të gjithë punëtorëve u ishte dhënë pushim pa pagesë. Nuk kanë bërë punë as protestat e njëpasnjëshme edhe para dyerve të fabrikës, para ndërtesës së Qeverisë dhe së fundit edhe para AKP-së.

Kërkesat e punëtorëve që t’u paguhen pagat që menaxhmeti u ka mbetur borxh gjatë gjithë kohës që kanë punuar, por që do t’u sigurohen kushte për punë nuk janë plotësuar. Ato nuk janë plotësuar edhe sot e kësaj dite.

Punëtorët patën kërkuar edhe nga AKP-ja që të bëjë trysni te pronari i kompanisë që t’i përmbushë obligimet që ka ndaj punëtorëve sipas kontratës të nënshkruar, por as kjo kërkesë e tyre nuk është realizuar.

Me fillimin e vitit 2015, gjendja ekonomike e këtyre punëtorëve dhe familjeve të tyre filloi të rëndohej. Rreth 60 familje që dikur mbaheshin nga puna e kryefamiljarëve në këtë gjigant industrial aplikuan për asistencë sociale, por edhe shumë prej tyre morën edhe rrugën e kurbetit.

Mbi 100 punëtorë të kësaj fabrike, të pakënaqur me gjendjen e krijuar, vazhduan me protestat herë para objektit të Komunës, para AKP-së, por edhe para Qeverisë duke kërkuar që të ndalet falimentimi i fabrikës, të bëhet kthimi i punëtorëve në punë, të bëhet rishikimi i procesit të privatizimit.

Gjendja e krijuar në këtë fabrikë ishte dhe mbeti preokupim i vazhdueshëm edhe i pushtetit lokal në Vushtrri.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, zoti Mulaku, vazhdimisht ka bërë përpjekje ta paraqesë këtë problem në shumë institucione. Por, tre vjet e gjysmë pas kësaj, ndërmarrja “Llamkos” nuk është duke prodhuar. Para dy javësh, pikërisht më 10 mars, një grup i punëtorëve të kësaj fabrike ka nisur sërish protestat para Agjencisë Kosovare të Privatizimit për t’i kërkuar rrogat që ua ka borxh ky institucion punëtorëve.

Sindikata e kësaj fabrike thotë se AKP-ja u ka borxh një milion e 720 mijë euro për gjithsej 478 punëtorë.

Kërkesa ime si deputete që vjen nga kjo komunë i adresohet fillimisht bordit të ri, pse jo pra atyre zyrtarëve që edhe vota ime sot i ka dërguar aty.

Të bashkëpunojmë me organet përkatëse që ky gjigant ekonomik të rivitalizohet përsëri.

Punëtorët që nuk e kanë marrë 20-qindëshin e takuar ligjërisht ta marrin menjëherë si kompensim.

Kërkesa tjetër i shkon Qeverisë, ministrave përkatës dhe Ju i nderuar kryeministër, që të gjejnë forma e programe që këto gjigante që janë jetike për regjionet dhe komunat tona të mos shndërrohen në kapital të vdekur, të amortizohen fizikisht dhe moralisht. Një gjigant ekonomik, siç është “Llamkos”, është shpresë ekonomike për mbi 500 familje në Vushtrri.

Unë besoj që me një përkushtim më të madh ka mundësi të zhvillohet një program strategjik për rivitalizim, jo vetëm për “Llamkosin”, por edhe për të tjera fabrika, si këto me fuqi prodhuese në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Izma! Tani Blerim Grainca e ka kërkuar fjalën, nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Melihate numër gjashtë je, kur e ke kërkuar fjalën? Urdhëro, Blerim!

BLERIM GRAINCA: Zoti kryeministër,

Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam këtu që sot me ju ta ndaj një shqetësim që vjen dhe ka qenë i pranishëm edhe këto ditë, e që ka të bëjë me Sektorin e shpezëtarisë, përkatësisht me Sektorin e prodhimit të vezëve.

E di se vezët ndoshta janë bërë pak problematike në këtë Kuvend kur ka ardhur koha që këtij problemi t'i qasemi me një qasje tjetër, e që ka të bëjë me interesat e Sektorit të Shpezëtarisë në Kosovë.

Këto ditë unë kam takuar shumë prodhues të vezëve, edhe Shoqatën e prodhuesve, dhe mund të ju them se ky sektor në Republikën e Kosovës ka të punësuar diku rreth 1 000 veta dhe mbulon 100% nevojat ditore të Republikës së Kosovës me prodhim të vezëve.

Mirëpo, problemi është se ky sektor po ballafaqohet me barriera dhe probleme të theksuara, e që lidhen si rezultat i një konkurrence jo të mirë, përkatësisht si rezultat i një importi joreal që po bëhet në Republikën e Kosovës.

Ky sektor prodhon rreth 800 mijë kokrra vezë në ditë, që është 110 deri 120% e prodhimit vendor, përkatësisht e nevojave vendore për vezë.

Por, vetëm në vitin që jemi tani, vetëm brenda tre muajve në Republikën e Kosovës kanë hyrë rreth tre milionë vezë nga Republika e Shqipërisë, përkatësisht nga importi dhe problemi është se të gjitha këto vezë kanë hyrë në emër të një kategorie që shkon për përpunim, përkatësisht për prodhimin të themi të makaronave, keqapëve apo gjërave të tjera dhe 100% këto vezë kanë përfunduar në marketet dhe dyqanet e Republikës së Kosovës, përkatësisht te kompanitë tregtare. Këto janë të dhënat nga Shoqata e prodhuesve të vezëve.

Prandaj, shtrohet pyetja: Si ka pasur mundësi që vezët që hyjnë për procesim të përfundojnë në treg dhe shtrohet pyetja nëse e ka kryer si duhet punën e tij institucioni që është përgjegjës për kontrollin e kualitetit, e në këtë rast është AVUK. Me këtë institucion edhe në të kaluarën kemi pasur bukur shumë probleme. Ju e dini aferën e importit të grurit, misrit e gjërave të tjera dhe që është një problem tjetër faturat e importit, të cilat i ka dhënë shoqata thonë se këto vezë hyjnë me një çmim të deklaruar në doganë tre centë e që është shumë më i ulët se sa kostoja e prodhimit të prodhimeve vendore, që është diku rreth shtatë centë.

Tani shtrohet pyetja: A janë, e kjo faturë dokumenton se këto vezë janë të kategorisë së dytë, apo kemi të bëjmë me dokumentacion i cili është bërë me ulje të vlerës së faturës vetëm për të pasur një evazion fiskal.

Në këtë rast do të duhej që urgjentisht AVUK-u dhe Inspektorati i Tregut, si dy institucione që janë përgjegjëse për këtë temë të merren me këtë problematikë, sepse këto produkte që vijnë në këtë formë e dëmtojnë edhe buxhetin e shtetit dhe prodhimin vendor, e mbi të gjitha e dëmtojnë shëndetin e konsumatorëve tanë, sepse edhe fëmijët tanë i konsumojmë çdo ditë.

Problemi është edhe më i madh kur kemi të bëjmë me faktin se këta prodhues kur dëshirojnë të dalin në tregun e rajonit, në tregun e vendeve fqinje ballafaqohen me probleme të jashtëzakonshme. Për shembull, në Republikën e Shqipërisë e kanë të pamundur të eksportojnë vezë për arsye se ballafaqohen me një burokraci të jashtëzakonshme të vendit fqinj, në këtë rast të Shqipërisë, e të mos flasim pastaj për Serbinë e për vende tjera.

Qeveria jonë, vendi ynë, vetëm në tre vjetët e fundit ka ndarë rreth 800 mijë euro për rritjen e produkteve, përkatësisht prodhimit në këtë sektor. Dhe, nëse ne e kemi arritur që nivelin e prodhimit ta ngremë në atë nivel sa të mbulojmë 100% nevojat vendore, pse nuk po bëjmë diçka edhe për t'i ruajtur këto kapacitete edhe nga konkurrenca joreale, por edhe për t'i stimuluar, për të dalë në tregjet e jashtme.

Prandaj, unë apeloj që Ministria e Tregtisë, Inspektorati, përkatësisht edhe AVUK-u nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë ta ngrenë nivelin e përgjegjësisë dhe të tërheqin nga konsumi këto vezë të cilat me dokumentacion janë vezë për procesim dhe kanë përfunduar në treg për konsum. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Grainca! Qerim Bajrami nga "6+" e ka kërkuar fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani predsedniče parlamenta,

Poštovani premijeru, ministri,

Poštovane kolege poslanici,

Ja sam zatražio reč za jednu po meni veoma važnu temu koju treba da odradi i naš parlament ali i Vlada Kosova. Radi se na ime o tome da mi kao republika Kosovo nažalost nemam uspostavljene diplomatske odnose sa Bosnom i Hercegovinom za to što država Bosna i Hercegovina još uvijek nije priznala Republiku Kosova.

Razlog zašto to nije uradila manje više svi znamo ali ga treba zbog onih koji često daje neke neumesne primedbe ponavljati to je dakle zbog toga što predstavnici Srpskog naroda u Bosnoj i Hercegovini imaju pravo veta u Predsedništvo te države i ne dozvoljavaju dakle da država Bosna prizna Republiku Kosovu.

Na ime, mi smo gotovo prije mesec dana ovde u Parlamentu Kosova imali jednu veoma važnu vizitu na osnovu poziva naše Komisije za vanjske poslove ove Skupštine, bio ovde uposliti oslani i predsednik komisije za spoljnu trgovinu i carine gospodin Šemsudin Mehedović. To je bila inače prva zvanična posjeda jednog zvaničnika iz Bosne i Hercegovine državi Kosova.

U tim susretima, koje smo imali ovde u Parlamentu Kosova, na jako visokom nivou i u Vladi Kosovo u Ministarstvo Vanjskih poslova, uglavnom je dogovoreno da se poradi na oba dvije strane oko ukidanja veoma rigoroznog viznog režima između Kosova i Bosne i Hercegovine. Ja koristim ovu priliku da se zahvalim gospodinu Šemsedinu Mehmedoviću i našoj komisije na svemu onome što smo do sada odradili, ali želim da napomenem i ovom prilikom da je jako bitno da se ovi koraci i dalje nastave i da naši kontakti i sa Parlamentom države Bosne i Hercegovine, ali i kontakti Ministarstva vanjskih poslova Republike Kosova i Ministarstva vanjskih poslova države Bosne i Hercegovine budu intenzivirani s ciljem da se što prije ukine vizni režim između Republike Kosova i države Bosne i Hercegovina.

O ovom smislu ja apelujem na naše Ministarstvo vanjskih poslova da preduzme sve potrebne korake, a mičemo kao Komisija vanjski poslova nastaviti sve naše aktivnosti s jednim jednim ciljem dakle da se što prije omogući sloboda kretanja ljudi, roba i usluga između Kosova i Bosne i Hercegovine. Nadam se da će i Vlada Kosova da shvati ovo pitanja veoma ozbiljno, jer u 21

vjeku ovde u regiji Balkana da postoji jedan tako rigorozan režim je nedopustivo i ne smemo dozvoliti da te naše odnose inače između dva prijateljska i bratska naroda narušavaju i poče oni koji su naneli toliko zuluma i ovde na Kosovu i u Bosni i Hercegovinu.

Dakle, ovo pitanje trebamo uzeti jako ozbiljno i poraditi na tome. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Bajrami! Kështu: Vetoni, Abdyli dhe Bekimi janë të fundit, tash Blerta Deliu Kodra e ka fjalën, pastaj Alma, Melihate Tërmlakli dhe Besa Gaxheri. Alma është në radhitje e para, jo Blerta është e para, Bekimi është i dyti, Alma ka qenë e treta, për korrekti elektronike. Nga pesë minuta.

Urdhëro, deputete!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër i vendit,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar ministra dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Si deputete, por edhe si prind, sot dua që të ndaj me ju një shqetësim të shumë prindërve, të cilët gjatë këtyre ditëve më kanë kontaktuar lidhur me zhvillimet e fundit dhe me brengën që ata kanë për thirrjet publike nga një parti politike opozitare drejtuar nxënësve të shkollave të Komunës së Prishtinës. Mbajtja e këtyre tubimeve politike, ku po shpalosen platforma politike, është në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi, përbën abuzim flagrant të fëmijëve dhe është politizim i skajshëm i institucioneve arsimore, si dhe shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve.

Për më keq, lejimi i Komunës së Prishtinës që Lëvizja “Vetëvendosje” ta ushtrojë këtë aktivitet është skajshmërisht jashtë elementit dhe mendimit politik, demokratik dhe qytetëruar që shkollat e Prishtinës me leje të Komunës së Prishtinës që qeveriset nga Lëvizja “Vetëvendosje” t’i shërbejnë kësaj partie politike për t’i shpalosur platformat e saj politike me nxënës të shkollave. Me këtë akt, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shkelur Ligjin për arsimin parauniversitar që në pikën 3, të nenit 4 thotë: “Ndalohej aktiviteti promovues jashtë kornizës së kurrikulumit të Kosovës në përfitim, ose në dëm të çfarëdo partie politike, të çfarëdo gjinie, të çfarëdo përkatësie racore etnike, të çfarëdo feje ose pozitës sociale nëpër institucionet arsimore në Kosovë. Nëse këto çështje paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësit do të duhej që t’u afrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta”.

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë sot do t’i drejtohem deputetit Kurti me disa pyetje: Në rast se janë pyetur arsimtarët, drejtorja, si dhe vetë nxënësit nëse kanë vullnet të lirë që ta dëgjojnë deputetin Kurti, si dhe këtyre nxënësve a u është imponuar vullneti i tyre për të dëgjuar? A është dashur që t’i pyetni nxënësit e shkollave nëse janë të interesuar që ta dëgjojnë platformën politike të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe a kanë qenë të gjithë nxënësit të interesuar që këtë platformë ta marrin në institucionin e tyre arsimor?

Kjo pyetje, pasi 90% e këtyre nxënësve janë nën moshën e lejuar me ligj dhe në këtë rast është abuzuar skajshmërisht me ta duke shpalosur debatet për ideologji, për më tepër ata janë të mbrojtur me të gjitha konventat dhe ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu,

shfrytëzimi i ambienteve shkollore, që për mua është një shqetësim tjetër, këto ambiente shkollore janë shfrytëzuar për t'u shpalosur platforma e Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe kjo është shkelje e Ligjit rreth konventave, të cilat janë të aplikuara në Kosovë.

Kjo praktikë e ndërhyrjes në sistemin edukativ arsimor është e papranueshme dhe duhet të ndalohet. Dhe, krejt në fund, me çfarë të drejte mund të keqpërdoren fëmijët tanë? Kjo është pyetje që më është parashtruar nga shumë prindër dhe sot po e ripërsëris: Me çfarë të drejte mund të keqpërdoren nxënësit dhe fëmijët tanë në institucionet arsimore, të cilat janë të dedikuara që të shfrytëzohen për t'u promovuar platforma arsimore? Unë dhe prindërit e tjerë që më kanë kërkuar të flas sot duam që të kërkojmë që të ndalen këto praktika nga Lëvizja "Vetëvendosje" dhe unë në vazhdim do t'i drejtohem edhe Ombudspersonit, do t'i drejtohem edhe ministrit të Arsimit që e kemi sot këtu dhe po ashtu do t'i drejtohem edhe ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me Ligjin për vetëqeverisje lokale, sepse Komuna e Prishtinës e ka shkelur skajshmërisht dhe në mënyrë flagrante këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Deliu-Kodra! Ministri i Arsimit e ka kërkuar fjalën për të njëjtën çështje.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër i Qeverisë së Kosovës,

Ministria e Arsimit dje e ka shprehur këtë shqetësim që e shtroi deputetja Deliu dhe ne u kemi bërë apel të gjitha komunave, partive politike opozitare, që ta shmangin cilindo aktivitet që do ta cenonte shkollën, që do të ndërhynte politikisht në shkolla dhe shfrytëzoj rastin edhe nga kjo foltore t'i ftoj të gjitha partitë politike opozitare që të mos ndërhyjnë në shkolla, i ftoj të gjitha drejtoritë komunale të arsimit që ta shmangin cilindo aktivitet politik, sepse jo vetëm që cenohet rëndë Ligji për arsimin parauniversitar dhe Konventa për të Drejtat e Njeriut, por cenohet edhe integriteti i fëmijëve, të cilët duhet të edukohen në frymën pozitive, jo me gjuhë të urrejtjes dhe ne nga sot kemi aktivizuar të gjithë inspektorët e arsimit për të takuar të gjithë drejtorët komunalë të arsimit që ata të dalin në terren dhe t'i vetëdijesojnë të gjithë drejtorët e shkollave që këto aktivitete janë të paligjshme.

Jemi shumë të kënaqur që shumica absolute e fëmijëve e refuzojnë këtë atak që bëhet në integritetin e nxënësve dhe i ftojme edhe një herë të gjitha partitë politike opozitare që t'i shmangin këto. Ka hapësira të mjaftueshme që ata t'i shpalosin qëllimet e veta politike brenda institucioneve, brenda Kuvendit të Kosovës, të mbrohen fëmijët tanë dhe atyre t'u ofrojmë një edukim pozitiv, jo që të ndikojmë në identitetin e tyre dhe në ngritjen e tyre arsimor dhe edukativ.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Për korrektësi, gjashtë diskutues janë, të gjithë do ta përfundojnë fjalën: Bekim Haxhiu, Alma Lama, Besa Gaxherri, Abdyl Ymeri, Melihate Tërmkolli, Veton Berisha. Kjo është radhitja. Tre do t'i largoj menjëherë pasi janë të gjinisë mashkullore, do të shkoj pastaj me radhë. Zonja Alma e ka fjalën, pastaj zonja Gaxherri, zonja Tërmkolli, pastaj vazhdojnë kolegët deputetë.

ALMA LAMA: Të nderuar deputetë!

Kjo është praktikë që bëhet edhe në Parlamentin Evropian, për të cilën unë kam folur në fillim të mandatit, kështu që mirë është.

Të nderuar, ka dy mijë vjet, prej që ka filluar historia e njerëzimit, që i diskriminoni gratë, e ju për një gjë të vogël bëheni tani...

Çështja që desha të ngre unë sot në Kuvend para deputetëve, por edhe para qytetarëve të Kosovës lidhet me financimin e Televizionit Publik. Para pak ditësh kemi marrë një letër nga Unioni i Transmetuesve Evropianë që i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe kryeministrit, ku saktësisht kërkohet që RTK-ja të financohet nga buxheti i shtetit. Kjo letër po përdoret si mbulesë për ta bërë realitet këtë propozim, i cili në fakt çuditërisht është edhe propozimi i RTK-së dhe i PDK-së

Meqë puna e Kuvendit monitorohet edhe nga Komisioni Evropian dhe shumë institucione ndërkombëtare, po e shpreh publikisht çudinë dhe zhgënjimin tim me këtë letër të IBIU-së, e cila na tregon se sa para duhet t'i japim RTK-së, meqë sipas tyre është rritur kostoja e dramave dhe e sportit. Kjo organizatë, ku bëjnë pjesë pothuajse të gjithë transmetuesit publikë evropianë, ka rënë në një nivel qesharak me këtë letër, duke na propozuar, apo më saktë duke bërë presion që ta shtetëzojmë Televizionin Publik.

IBIU madje merr si shembull që duhen ndjekur vendet e rajonit, duke harruar se televizionet publike të rajonit në përgjithësi janë megafon i partive në pushtet. IBIU është një organizatë evropiane, e cila si duket nuk e ka lexuar Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit të shkuar, i cili thotë: “Transmetuesi Publik, pra RTK-ja mbetet i varur nga financimi shtetëror, nga Buxheti i Kosovës, i cili e minon pavarësinë e tij editoriale”. Komisioni Evropian pra na thotë se financimi i shtetit e minon pavarësinë editoriale, ndërsa IBIU-ja apo Unioni i Transmetuesve Evropianë thotë se duhet ta vazhdoni financimin nga shteti.

Këtë letër unë e konsideroj si skandal pas të cilit fshihet diçka. Në IBIU shumica absolute e televizioneve financohen nga parapagimi, e nëse këtij institucioni ia merr mendja se ne jemi injorantë dhe i konsiderojmë rekomandimet e tyre si të shenjta e kanë gabim. Ne presim nga institucionet evropiane që të na propozojnë shembujt më të mirë, të cilat i shkojnë për shtati një vendi demokratik, të cilin aspirojmë, e jo shembuj të tipit ruso-kinez. Personalisht jam për zhvillimin e RTK-së dhe sigurimin e një financimi të qëndrueshëm që do të mundësonte pavarësinë editoriale që sot nuk e ka, por edhe jam për transparencën e financave të RTK-së dhe për shfrytëzimin e buxhetit për nevojat e vërteta të publikut, e jo për abuzim masiv me paratë e publikut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Lama! Tani zonja Gaxherri, përgatitet zonja Tërmkolli. E përdora radhitjen elektronike po më vjen keq, të mos mendoni në preferenca personale.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,
Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Qytetarët e Republikës së Kosovës janë shumë të shqetësuar me rastin e njoftimit nga mediet e Republikës së Kosovës për mënyrën e faturimit nga KEDS-i për shpenzimin e energjisë elektrike në kurriz të konsumatorëve të ndershëm dhe korrektë në pagesat e faturave.

Qytetarët e Republikës së Kosovës, përveç se furnizohen me energji jokualitative, e cila ka kosto shumë më të lartë, kur nuk është e tillë, këta i paguajnë edhe shpenzimet, pra faturat e konsumatorëve të cilët e keqpërdorin dhe e vjedhin energjinë elektrike. Kësaj padrejtësie dhe abuzimi me konsumatorët e ndershëm duhet t'i vijë fundi urgjentisht. Zoti ministër Stavileci, që fatkeqësisht sot s'qenke këtu, kërkojmë nga ju që menjëherë të merrni masat ligjore dhe sa më shpejt që të jetë e mundur t'u përgjigjeni qytetarëve të Republikës së Kosovës për masat që i keni ndërmarrë.

Njëkohësisht, kërkojmë nga Komisioni për Ekonomi, Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti e Industri që ta ftojë në raport Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Elektrike, komisioni ta njoftojë Kuvendin me gjendjen reale dhe të rekomandojë rekomandime konkrete për të cilat ky Kuvend pastaj do të marrë vendim të caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Gaxherri! Tani zonja Tërmkolli e ka fjalën. Përgatitet Vetoni, pastaj Abdyli, Bekim, edhe pse ke qenë i pari po të bie në fund.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Unë po i kthehem prapë atij nderimi që i bëri edhe kryeministri, edhe kryetari i Parlamentit dhe të gjithë deputetët 17-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s, në këtë 17-vjetor të ndërhyrjes së NATO-s në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndaj caqeve ushtarake policore të Serbisë, e që rezultoi me çlirimin e Kosovës.

Është e habitshme se si edhe 17 vjet pas ne në Kosovë, apo në veçanti në Prishtinë, nuk kemi një memorial, nuk kemi një lapidar, në shenjë falënderimi për kontributin e pazëvendësueshëm të NATO-s, për shpëtimin e popullit të Kosovës dhe çlirimin e Kosovës nga Serbia.

Unë propozoj që sot, nga sot Qeveria e Kosovës ta ketë parasysh një gjë të tillë dhe t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm, që vitin e ardhshëm në shënimin e përvjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në çlirimin e Kosovës ta kemi një memorial, ta kemi një lapidar, sepse ishte akti ndër më të rëndësishmit në historinë edhe të NATO-s, po sigurisht edhe në realizimin e vullnetit dhe kërkesave të qytetarëve të Kosovës për liri dhe për pavarësi.

Zoti kryetar,

Unë sa i përket kësaj çështjeje e kreu. Sa i përket radhitjes, mund të them se po e shoh që diçka s'është në rregull. S'po them ndonjë fjalë të rëndë "dallavere" a ndonjë... po, diçka ka këtu.

Unë sot kam ardhur e dyta, deputeti i dytë që kam hyrë në sallë të Kuvendit, veç Ali Sadriu ka qenë para meje në këtë sallë dhe kam shtypur menjëherë pullën për ta kërkuar fjalën. Krejt këta që folën para meje, kanë ardhur pas meje. Tash, çka po ndodhë këtu? Kush po bën e çfarë po bën nuk e di, por e di që diçka s'është në rregull! OK! Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të publikut, për korrektësi, mundohem ta mbaj, por për fjalë të nderit, kjo ka qenë radhitja, për fjalë të nderit. Edhe pse, nuk është... është çështje shumë e thjeshtë, por sido që të jetë mirë do të ishte kryetarët e grupeve parlamentare të ma japin radhitjen dhe e bëjmë në pastaj atë formë. Zoti Veton Berisha, e ke fjalën. Bëhet gati zoti Ymeri dhe zoti Haxhiu, në fund.

VETON BERISHA: I nderuar kryetar Veseli!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë dhe gjithë ju të pranishëm,

Zoti kryetar,

Unë flas në cilësi të deputetit të Kuvendit të Kosovës dhe më lejoni që... unë kërkoj mirëkuptimin tuaj, për shkak se ka një kohë që e kemi një shkëputje nga fjalimet tona në Kuvend dhe ndoshta do të zgjatet pak, sepse do të përfshihen gjëra që janë mbledhur brenda kësaj periudhe kohore.

Unë në radhë të parë shpreh shqetësimin tim, që jemi pothuajse në fund, në javën e fundit të marsit dhe akoma Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka miratuar programin për projekte kapitale, e cila është zotuar me Ligjin për Buxhet, më saktësisht me nenin 10 të Ligjit për Buxhet, nën ky i cili është diskutuar mjaft dhe ka qenë njëri prej kompromiseve tona, që ne i kemi arritur dhe ne jemi në fund, domethënë veç kemi filluar në pjesën e dytë të vitit, të gjashtëmujorit të parë dhe akoma nuk ka lëvizje dhe diskutime rreth kësaj çështjeje. Ndoshta, nuk jemi të njoftuar, por vërtet do të duhej që menjëherë pas miratimit të Buxhetit ky plan të vijë, sepse një pjesë e madhe e kohës shkojë dhe nuk e di se si do të arrijmë në implementimin, sa do të jenë komunitetet tona të kënaqura, në këtë rast edhe komuniteti egjiptian. Dhe, ftoj që ta kemi një bashkëpunim në raport me ne, sepse në këtë plan të veprimit, në këtë program do të duhej të dëgjohemi edhe ne dhe të jenë konform, programi do të duhet të jetë konform nevojave tona dhe çështjeve që ne i kemi paraparë.

Shqetësimi i dytë është, për shkak se ka kaluar një periudhë dhe gjërat janë diskutuar dhe jemi munduar ta ndryshojmë gjendjen, mua më duhet që publikisht të paraqes një shqetësim timin dhe të komunitetit egjiptian, të cilin unë e përfaqësoj, ndaj Ministrisë së Arsimit dhe ministrit, përkatësisht stafit të tij, për shkak se brenda kësaj periudhe kohore ne kemi disa ndoshta, moskuptime ose moskoordinime të veprime. Unë fola prej vendit për shkak që ta kemi edhe një përballje kështu të drejtpërdrejtë dhe ndoshta do të ishte mirë që të shikohemi. Brenda kësaj periudhe ka ndodhur një pakënaqësi e komunitetit tonë dhe një moskoordinim jashtëzakonisht i madh në mes të interesave të komunitetit tonë dhe politikave të ministrisë. Veç po i citoj, kemi dështuar në regjistrimin e studentëve të komunitetit egjiptian, kemi dështuar, ka rritje të vazhdueshme të procesit dhe braktisjes së procesit mësimor. Ne kemi reaguar dhe nuk ka veprime konkrete. Nuk ka masa stimuluese në raport me ngritjen e nivelit të edukimit të komunitetit evropian, të cilat vërtet do të duhej të jenë në interes edhe të shtetit, sepse po të kesh analfabetë brenda vendit tonë, nuk besoj se është interes i dikujt dhe këto masa duhet të ndërmerren dhe shikohen.

Kemi disa kërkesa në vazhdimësi, që ne të takojmë ministrin dhe këshilltarët e tij, kemi fakte që jemi neglizhuar dhe nuk kemi arritur t'i kemi këto kontakte, në mënyrë që ne, jo të kritikojmë, por të japim kontributin tonë në raport me interesat tona dhe mendoj që ministri do të duhej t'i

akceptojë dhe të flasë me stafin e tij, që të na akceptojë, sepse është në interes të secilit që çështjet tona të diskutohen dhe niveli i edukimit të rritet, sepse secili prej nesh e dimë se si kemi kaluar para viteve '99 me një edukim të errët dhe nuk do të duhej që edhe në vitin 2016 ta përjetojmë sërish për të dytën herë këtë situatë.

Jemi në proces të Ligjit për arsimin e lartë, është në diskutim edhe në Qeveri dhe këtu po ashtu, ftoj që këto dilema, këto probleme, që ne i kishim brenda kësaj periudhe të sqarohen dhe me Ligjin për arsimin e lartë, që edhe ju, zoti ministër, ta keni më të lehtë zgjidhjen e problemeve tona e të mos mbeten 25 pjesëtarë të komunitetit egjiptian, të cilët më mirë do të ishte të jenë në universitet se sa në rrugë apo të largohen nga Kosova për arsye të humbjes së shpresës.

Çështje tjetër është dështimi dhe pakënaqësia jashtëzakonisht e madhe e imja dhe komunitetit të cilin unë e përfaqësoj, ndaj Ministrisë së Administratës Publike dhe ministrit Jagxhëllar, i cili është përgjegjës që dy mandate për menaxhimin e kësaj ministrie, e në veçanti për implementimin e nenit 11 të Ligjit për shërbyesit civilë, nen i cili garanton që duhet të jetë një bilanc i të punësuarve në Administratë Publike për të gjitha komunitetet, ndërsa kjo shifër e komunitetit egjiptian ka mbetur e pandryshuar akoma që dy vjet, i kemi gjetur vetëm 14 të punësuar dhe sot pas dy vjetësh akoma janë 14, nuk ka lëvizur asgjë. Dhe, me këtë rast ftoj edhe ministrin e Financave, sepse zakonisht referencat jepen tek ministri, sepse ministri i financave duhet të parashohë buxhet për lejimin e vendeve të punës.

Nuk po dua të bëj krahasim, por vërtet derisa ka pasur mundësi të bëhet për një komunitet të caktuar, t'u sistemohen, duke pasur parasysh edhe situatën politike, rreth 450 vetë të një komuniteti të caktuar, atëherë pse të mos jenë edhe 100, ose 50 dhe aq sa ka mundësi dhe aq sa i plotësojnë kushtet. Unë mendoj që ne kemi pjesëtarë të komunitetit të cilët janë me nivel të përgatitjes dhe i plotësojnë të gjitha kushtet që Administrata Publike. E ftoj zotin kryeministër, që të shikojë dhe të bisedojë me ministrin e Administratës Publike dhe të ndërmarrë veprime konkrete në raport me implementimin e nenit 11 të Ligjit për shërbyesit civilë dhe Rregullores 04/2010, Rregullore e cila i jep obligim edhe ministrisë që të ndërmarrë veprime konkrete në implementimin e atij neni.

Çështje tjetër, zoti kryeministër, është, kemi edhe ministrin e Drejtësisë këtu, komuniteti egjiptian dhe ashkalinj, po flas me të drejtë të plotë sepse i di dhe kemi informata të mjaftueshme, akoma po ballafaqohet me problemin e pengim-posedimit dhe uzurpimin e pronave. Unë e di që zgjidhje e këtyre problemeve janë gjykatat, por vërtet gjykatat nuk kanë mundësi, e dimë në çfarë procesi gjenden dhe sa raste kanë mbetur akoma pa u shtjelluar, por unë mendoj që duhet një rezolutë, apo një qëndrim qeveritar, në raport me këtë dukuri. Unë e kam plotë në adresimin tim dhe në atë çfarë përfaqësoj, plotë familje që deklarojnë dhe kanë akoma problem me këtë dukuri. Ndoshta kjo ish dashur secilit prej nesh t'i japë të drejtë dhe ftoj secilin prej jush, që vërtet kjo dukuri të eliminohet njëherë e përgjithmonë. Aq më tepër, në kuadër të kësaj dukurie është një dukuri shumë e pahijshme, për shkak se po detyrohen t'i shesin pronat e tyre me çmime simbolike vetëm e vetëm që ta plotësojnë faktin e kontratës së shitblerjes. Kështu që, na duhet një politikë e përbashkët e përgjithshme që kjo dukuri të mos jetë në mesin tonë.

Kërkoj që komuniteti egjiptian të jetë i përfshirë në proporcion me numrin e anëtarëve të komunitetit në forcën e sigurisë, në Policinë e Kosovës, Dogana dhe gardianë. Mendoj që është në interes të secilit prej nesh, që edhe në këto mekanizma të ketë pjesëtarë të mjaftueshëm të komuniteteve tona, aq më tepër edhe ata aktualë që janë që 15 vjet pjesa më e madhe e tyre, ose asnjë nga ata, nuk janë ngritur në pozita, kanë mbetur në pozitë fillestare në të cilat kanë filluar. Ju e dini, që ka obligime që secili nga komunitetet brenda kushteve që ata i plotësojnë, të kenë edhe pozita të graduara dhe të jenë nëpër këto vende, që ne na takojnë.

Është një dukuri e pahijshme, me të cilën komunat dhe ministri i Infrastrukturës do të duhej të merren, për shkak se nuk e di pse ndodh, por ndodh, është fakt, mund të dalim në terren dhe ta vërtetojmë, pikërisht në zonat ku jetojnë komunitetet tona ndërpriten investimet kapitale, ndërpriten rrugët, ndërpriten ndriçimi, ndërpriten kanalizimi. Po flas me përgjegjësi të plotë dhe mund t'i vërtetojmë të gjitha këto fakte. Ndoshta, nuk është e tëra në domenin e ministrit, por vërtet këto dukuri edhe komunat duhet t'i kenë parasysh, që nëse arrijnë t'i bëjnë 10 kilometra, atëherë edhe 2 kilometra më shumë, nuk do të duhej të ishte e dëmshme, e aq më tepër në momentin kur fillon vendbanimi i komuniteteve tona.

Zoti kryeministër, po ashtu kemi marrë premtimin e juaj dhe i kam dorëzuar, deponuar, edhe arsyet tona për largimin e komunitetit evropian nga draft-strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian, strategji kjo e cila na ka përcjellë vazhdimisht dhe na ka lënë të izoluar brenda tri komuniteteve, të cilat kanë qenë përafërsisht të njëjta në një pozicion dhe ne kërkojmë largim nga kjo draft-strategjia 2016/2020, strategji kjo e cila nëse ne qëndrojmë aty do të qëndrojmë gjendja kjo që është. Ne nuk jemi të interesuar të qëndrojmë aty ku kemi qenë, jemi të interesuar që të jemi të përfaqësuar, të trajtuar, të barabartë me të gjitha komunitetet në Kosovë. Trajtohemi vetëm bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligje të aplikueshme dhe të mos bëhen dokumente sa për sy e faqe dhe t'u mbyllen sytë edhe donatorëve edhe të njerëzve në Kosovë që "për komunitetet është bërë mjaft, sepse është krijuar një strategji". Strategjia e kaluar 98% është konsideruar se është e dështuar. Kanë ardhur mjaft fonde, kanë ardhur shumë investime në emër të këtyre komuniteteve dhe gjendja ka mbetur e pandryshuar. Unë flas për komunitetin egjiptian, sepse mbaj këtë të drejtë, jam i zgjedhuri i tyre dhe unë kam realizuar edhe peticion në raport me ta, e kam marrë mendimin e tyre. Ata janë të njëzëri që egjiptianët të largohen nga kjo strategji dhe të mos ekzistojnë fare aty.

E fundit, më falni, e parafundit, Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve, dy mekanizma shumë të rëndësishme me Kushtetutë që janë paraparë edhe me vullnet politik të Qeverisë së kaluar edhe tash dhe këto dy ministri, këta dy mekanizma janë shumë të rëndësishme, quhen të rëndësishme sepse do të duhej t'i mbrojnë interesat e komuniteteve tona, ndërsa vetë fakti i përbërjes së këtyre ministrive dhe vetë fakti i investimeve që bëjnë këto ministri, domethënë bilancin se ku investojnë kjo ministri dhe kjo zyrë tregon mjaftë se për kë janë të krijuara këto ministri, atëherë të marrim një vendim dhe të definojmë mandatin e kësaj ministrie dhe zyrës tuaj, zoti kryeministër, për komunitete, se a janë për komunitete apo janë për komunitetin serb. Nëse janë për komunitetin serb, pajtohem, sepse është politikë stimuluese dhe le të veprohet andej, ndërsa ne mos të jemi të përfshirë në politika dhe me statistikat e tyre, kinse ne e kemi një ministri të kthimit dhe komuniteteve e në fakt nuk bëhet asgjë. Dhe urdhëroni, cilat janë raportet tona dhe secili nga komunitetet tona mund ta

paraqesë arsyen e tyre, se sa janë të kënaqur me këtë ministri. Ju ftoj, që të ndërmerri masa në kuadër të kompetencës tënde, që të definohet mandati i kësaj ministrie.

E fundit, shumë e rëndësishme, ne si pjesëtarë të komunitetit joshumicë në përgjithësi, brenda kësaj periudhe kohore të bllokadës politike kemi qenë në një pozicion, me thënë jo të nivelit të kënaqshëm për një arsye, për shkak se edhe është thënë që “ju të komuniteteve nuk keni të drejtë dhe nuk duhet të përziheni në çështjet që janë vetëm të shqiptarëve”. Unë mendoj që këto deklarime janë jashtëzakonisht të ulëta dhe vërtet na bëjnë të mos ndjehemi mirë, për shkak se ky shtet është po ashtu i yni dhe çdo interes që i cenohet këtij vendi, ne e kemi përgjegjësi dhe deklarohemi që do ta mbrojmë. Unë si përfaqësues i këtij komuniteti, pavarësisht që jam në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe në Qeveri, çdo çështje që e cenon shtetin, shtetësinë dhe qytetarin e Republikës së Kosovës asnjëherë nuk do i bashkëngjitëm dhe nuk do e përkrah por këto duhet të jenë normalisht të vërtetuara dhe të bazuara dhe normalisht, që ne duhet të jemi të përfshirë edhe në këto çështje, sepse janë interes edhe demarkacioni edhe asociacioni janë interesa po ashtu, tona, sepse kjo shtetësia e Kosovës është edhe e jona. Unë kërkoj falje, zoti kryesues, për zgjatjen, por ishte një periudhë e gjatë që ne s’kemi pasur mundësi të drejtohem. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Zoti deputet, më duhet ta them që ke folur rrafsh 12 minuta. Tutje s’po komentoj, por i lus këta të tjerët që të flasin nga 3 minua, se aq u thotë Rregullorja. Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuar kryeministër,
Ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Bazën e shtetësisë së Kosovës ia vuri arsimi, thotë Bajram Shatri, autor i librit “Arsimi shqip në Kosovë, 1990-1999”, i cili në mënyrë të detajuar shkruan për organizimin e sistemit të arsimit në këtë periudhë pas dëbimit të studentëve dhe profesorëve nga Universiteti i Prishtinës dhe nxënësit nga shkollat e mesme, nga ana e administratës së dhunshme serbe.

Ishte periudhë e mbijetesës së qenies shqiptare në këtë pjesë të gjeografisë shqiptare. Nga ana tjetër kishte një entuziazëm, gatishmëri e vullnet për të rezistuar, mobilizuar e organizuar, për të punuar edhe në këto kushte të vështira të okupimit klasik.

Kishte një solidaritet të madh në mes të njerëzve dhe ishin të gatshëm të japin kontributin e tyre në organizimin e mësimi nëpër shtëpitë shkolla, përkundër rrezikut që u kanosej në çdo moment.

Padyshim se kontribut të çmuar dhe të veçantë dhanë 3.200 pronarë të shtëpive shkolla si dhe 22 000 mësimdhënës të cilët mundën frikën dhe iu përvishen punës për të shpërndarë dije për 400 000 nxënës e studentë.

Po e ngrit këtë çështje se është marrë një vendim për shpërblimin e mësimitdhënësve të vitit 1990 nga qeverisja e kaluar, e cila ka dhënë premtimin se do t'u njihet puna mësimitdhënësve për këtë periudhë.

Unë besoj shumë se të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre për mbijetesën e shkollës shqipe gjatë viteve të '90-ta nuk kanë menduar asnjëherë për ndonjë kompensim material, por qëllim të vetëm kishin që arsimi shqip të mos ndalet.

Mirëpo sot institucionet tona dhe ky Parlament ka për obligim që përmes ligjit ta rregullojë dhe njëhë punën e mësimitdhënësve dhe të gjithë atyre që kontribuan për këtë periudhë.

Unë mendoj se kjo do të jetë më shumë një mirënjohje e cila praktikisht ka më shumë efekt moral sepse e njëh punën për gati një dekadë për të gjithë mësimitdhënësit të cilët kanë mbijetuar në kohën më të vështirë kur ne jemi ballafaquar në mes të jetës dhe vdekjes.

Po besoj se kjo Qeveri do ta ketë parasysh këtë dhe do ta procedojë projektligjin në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër, kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që edhe kryetari u mor me renditjen, them se është me rëndësi njeriu çfarë do flet dhe jo e cila do të jetë renditja në fjalimin e tij dhe gjithsesi në këtë moment të veçantë sot të 17 dhjetorit të intervenimit të NATO-s nuk mund ta kalojmë pa shprehur konsideratën tonë më të thellë për Aleancën më të fuqishme, e cila përkrahu popullin tonë, e shpëtoi popullin tonë dhe ndihmoi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në rrugën e saj të lirisë.

Sot, në këto momente, edhe populli evropian është i kërcënuar nga forca të errëta terroriste, të cilat po e kërcënojnë civilizimin evropian, prandaj ne sot ndjejmë dhembje me popullin belg, ndjejmë dhembje me popujt e Evropës të cilët po kërcënohen nga terrorizmi.

Ne jemi me popullin belg! Jemi me popullin evropian dhe jemi të bindur se Evropa, Amerika dhe bota demokratike do të ngadhënjëjë mbi terrorizmin.

Kosova i është bashkëngjitur luftës globale kundër terrorizmit dhe kërkojmë edhe një angazhim më të madh të aktorëve të sigurisë në këtë luftë globale kundër terrorizmit.

Kur jemi te lufta globale kundër terrorizmit, mund të themi lirisht se fillet dhe celulat e terrorizmit kanë filluar në vendet e pazhvilluara, prandaj zhvillimi ekonomik sot në Kosovë nuk është vetëm prioritet për mirëqenien dhe ngritjen e jetës së qytetarëve për përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve, por është prioritet edhe për sigurinë e tyre dhe për sigurinë e popujve të Evropës.

Prandaj, këto ditë ka qenë strategjia apo mund të them se ka qenë Ligji për Trepçën, është formuar nga Qeveria Grupi punues për Ligjin për “Trepçën”, për çka shpreh konsideratën time për hapat e parë për draftimin e Ligjit për “Trepçën”, për arsye se kjo do të jetë një nga prioritetet e zhvillimit ekonomik.

Trepça ka qenë edhe në të kaluarën një nga promotorët e zhvillimit ekonomik. Trepça do të duhej të ishte edhe sot një nga promotorët e zhvillimit ekonomik dhe duhet të jetë edhe në të ardhmen. Por, strategjia për “Trepçën” do të duhej t’i paraprijë Ligjit për “Trepçën”.

Jam i bindur se paraprkishtë Qeveria do të duhej të themelonte një grup punues për strategjinë për Trepçën dhe Ligji për “Trepçën” pastaj të inkorporohej në kuadër të asaj strategjie.

Prandaj shfrytëzoj rastin sot të kërkoj që nga kjo foltore të ftoj Qeverinë që, së bashku me aktorët tjerë, të themelojnë grupin punues për strategjinë për “Trepçën”, ku do të inkorporohet edhe Ligji për “Trepçën”.

Dhe kur jemi te Trepça, gjithsesi nuk mundem të anashkaloj faktin e gjendjes aktuale në “Trepçë”, e cila po përballlet me një gjendje të rëndë të menaxhimit, me një keqmenaxhim të viteve të fundit dhe kjo gjendje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Po, kryeje më shpejt!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kjo gjendje e kësaj strategjie, të ligjit për “Trepçën” duhet të përcillet me një menaxhment të përgjegjshëm i cili do ta zhvillojë “Trepçën”. Vite më parë, “Trepça” kur udhëhiqej nga zoti Shala ka pasur një bilanc pozitiv prej 15 milionë eurove, ndërsa sot është zhytur në borxhe nga menaxhmenti aktual. Ky menaxhment nuk meriton një përkrahje nga Qeveria por duhet bërë hapa drejt ndryshimit të menaxhmentit dhe zhvillimit të “Trepçës”, bashkë me Ligjin dhe strategjinë e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

Nuk do të zgjas si kolegët e mi. Desha të ngriti një shqetësim për kthimin i cili bëhet kthim i dhunshëm i komuniteteve nga Diaspora dhe më herët e kemi thënë po në këtë Kuvend, ato familje që kthehen me dhunë së paku t’u bëhet një zgjidhje, por deri më tani shumë familje që janë afër 650 familje që janë kthyer nga vendet e treta dhe pothuaj se mbi 55% kanë mbetur në rrugë dhe asnjë organizatë e as Ministria e Kthimit po as edhe Zyra e kryeministrit për çështje të komuniteteve nuk i merr këto familje përsipër dhe ne për çdo ditë kemi vazhdimisht probleme me këto familje sepse ata kur kthehen nga vendet e treta u thonë se do ta merrni një grand nga Qeveria dhe do të keni mbikëqyrjen nga Qeveria që së paku do të merret me strehimin e juaj por edhe të disa projekteve për të cilat u takojnë dhe ato të cilat i japin këto asnjë organizatë deri më tani nuk merret me këto, sidomos këto familje që kthehen në vitin 2016 nuk kanë kurrfarë përkrahje as nga organizatat por as nga Qeveria.

Kërkesa ime është që së paku të ndahet nga Ministria e Kthimit dhe nga Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve një fond dhe së paku këto familje të jenë përfituese e të mos mbesin në rrugë.

Dua të ngriti edhe një shqetësim tjetër. Ne në këtë Kuvend kur e kemi miratuar buxhetin kemi kërkuar që së paku kodi i veçantë për komunitete dhe 40% janë ndarë nga Ministria e Kthimit që komunitetet jo serbe ta shfrytëzojnë buxhetin po në këtë Ministri, mirëpo s'e di për çfarë arsye kjo po përsëritet sikur në vitin 2014 e 2015 dhe edhe në këtë vit fare nuk bëhet implementimi i këtij buxheti, i cili i është ndarë kodi për komunitete jo serbe 40% në këtë Ministri por edhe 50% në Zyrën e kryeministrit për çështje të komuniteteve, 50% ndahen për komunitetet jo serbe, 50% për komunitetin serb dhe këtu fare nuk ndahet ky fond dhe prapë shkon me avazin e vjetër sikur që janë shfrytëzuar në vitet e kaluara vetëm për një komunitet, prapë janë duke u shfrytëzuar edhe tani.

Kërkojmë nga ministri i Financave, nga Abdullah Hoti që së paku t'i bëjë disa sqarime dhe të bisedojë me ministrin dhe me atë zyre për çështje të komuniteteve - për çfarë arsye nuk bëhet implementimi i këtij buxheti, të cilin po ne në këtë buxhet e kemi ndarë kodin e veçantë për të gjitha komunitetet.

Ne e kemi ditur dhe e kuptojmë që vetëm një komunitet, ai egjiptian, ka qenë kundër këtij kodi dhe ata nuk kanë dashur të jenë pjesë e këtij kodi, por për këto komunitete na kemi votuar në Kuvend dhe unë kërkoj që së paku ky kod të implementohet dhe të zbatohet për komunitetet tona të cilin po në këtë Kuvend e kemi votuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo pikë e rendit të ditës u krye. Kalojmë në pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45 paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat më së shumti 60 minuta.

Deputetja Salihe Mustafa ka pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryesues!

Zoti ministër, pa dashur të ceku edhe një herë rëndësinë e autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë, sepse tanimë dihet që përveç rëndësisë jetike për Anamoravën kjo autostradë e lidhë edhe Luginën e Preshevës me ne. Andaj, pyetja ime për ju është: A mund të na njoftoni se në cilën fazë është projekti i kësaj autostrade dhe cilët janë hapat tjerë që priten në vazhdim?

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuara zonja deputete Mustafa,

Siç jeni të njoftuar, projekti i rrugës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë është investim në infrastrukturën rrugore për të lidhur drejtimet gjegjëse.... gjegjësisht autostradën Ibrahim Rugova dhe Arbër Xhaferi me korridorin 10 evropian, që të lidhë Anamoravën dhe Luginën e Preshevës me kryeqytetin dhe natyrisht ne me korridoret ndërshtetërore.

Projekti është ndarë në dy segmente. Segmenti i parë që përfshin rrugën Prishtinë - Gjilan dhe segmenti i dytë që përfshin rrugën Gjilan - Dheu i Bardhë - Konçul.

Deri tani është kryer projekti detal për segmentin e dytë Gjilan - Dheu i Bardhë - Konçul dhe po punohet në elaboratin e shpronësimit.

Sa i përket variantit shtesë, ju e dini që i kemi pasur dy variante, të propozuara për segmentin kycja me autostradën “Arbër Xhaferi” në Lipjan deri në Bresalc dhe aktualisht po kryhet matja gjeomekanike për përfundimin e projektit detal.

Ne presim që projekti i plotë detal të kryhet në fillim të muajit maj. Në ndërkohë është punuar edhe drafti i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social.

Më lejoni të ju njoftoj se autostrada tanimë është pjesë e projekteve të aprovuara nga Këshilli Kombëtar për Investime, kurse Qeveria në mbledhjen e saj të mbajtur me 15 mars e ka përfshirë këtë autostradë në grupin e projekteve për financim nga institucionet financiare ndërkombëtare në përputhje me klauzolën për investime të dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në harmoni me këtë, drafti preliminar i projektit, ai që është punuar deri tash, i është dorëzuar për shqyrtim Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim nga e cila presim përgjigje pozitive në muajt e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete, keni pyetje shtesë? Salihe Mustafa!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryesues!

Të faleminderit ministër për përgjigjen. Unë e kam shtruar disa herë këtë pyetje dhe sipas njoftimeve tuaja që na i dhatë, shpresoj që mos të takohemi me pyetje më në Kuvend por të takohemi në fillimin e punimeve në këtë autostradë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Tashmë kjo çështje, që unë po dua ta ngriti sot, është më e njohur për opinionin. Fjala është për rastet e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj të cilët po kërkojnë të drejtat e tyre.

Ne e kemi të njohur vendimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe vendimin që është nxjerrë nga po ky Kuvend për rastin në fjalë.

Pyetja është: I nderuar zoti kryeministër, a mund të na njoftoni se kur pritet që këta punëtorë t'i marrin kontributet e tyre që u takojnë, tash pasi që e kemi edhe Bordin e AKP-së të zgjedhur? Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryesues, nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit zonja deputete,

Tani unë këtë pyetje e kam pasur përpara të prezantuar me shkrim, mirëpo mund të them se tani është kompletuar Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Çështja mund të trajtohet. Është një çështje e cila e ka kaluar një periudhë të gjatë, në të cilën nuk është dhënë përgjigje.

Ju e dini se sipas rregullativës ligjore, çdo kompani e cila është privatizuar i ka mjetet e veta të ndara në mirëbesim.

Kjo do të thotë se mjetet të cilat janë në mirëbesim nga shitja, përkatësisht privatizimi i kësaj fabrike, nuk janë ato që pretendojnë punëtorët dhe ato për të cilat ka vendosur Gjykata Kushtetuese. Është çështje ligjore sa mund Agjencia Kosovare e Privatizimit të vendosë që mjetet nga kompanitë e tjera të mirëbesimit t'i shfrytëzojë për këtë rast.

Ne do të kërkojmë që ata të japin përgjigje për këto mundësi. Ndërkaq për mundësi të tjera është Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili mund të vendosë. Në qoftë se ne mendojmë se shpenzimet e tilla mund t'i përballojmë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, është një çështje tjetër. Unë nuk mendoj kështu, sepse ne do të futeshim në një cikël, nga i cili s'do të mund të dalim fare në këtë mandat. Me çfarë baze ligjore dhe kushtetuese e ka sjellë Gjykata Kushtetuese, nuk është në kompetencën time që unë të komentoj. Mirëpo, do të kërkojmë përgjigje nga autoriteti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete, ke pyetje shtesë? Nuk ka. Faleminderit! Deputeti Raif Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

E kam një pyetje për zotin kryeministër: Zoti kryeministër, që të krijohen kushte për ekonomi me konkurrencë të lirë, që të pengohen të gjitha format e pozitës monopoliste në treg, institucionet përkatëse të Kosovës e kanë nxjerrë Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Po ashtu, është themeluar edhe Autoriteti Kombëtar i Konkurrencës si institucioni kompetent për pengimin e dukurive të tilla që e çrrëgullojnë tregun e lirë.

Ju si kryeministër, por dhe pjesëtarë të tjerë të Kabinetit qeveritar, në vazhdimësi jeni deklaruar për krijimin e kushteve të volitshme të të bërit biznes, njëri prej parakushteve të të cilit është

edhe konkurrenca e lirë. Por, kjo frymë theksohet edhe në strategjinë kombëtare të zhvillimit 2016-2021, të nxjerrë nga po kjo Qeveri.

Në kundërshtim me të gjitha këto që i thashë më sipër, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës si institucioni përgjegjës për rregullimin e tregut është krejtësisht jofunksional që prej mesit të vitit 2013, ndërsa edhe dy vjet paraprake ka qenë vetëm pjesërisht funksional.

Është kështu, sepse Komisioni i Konkurrencës, që është struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës, nuk e ka aktualisht asnjë anëtar të zgjedhur si pasojë e dëmeve të pallogaritshme që kanë pësuar bizneset dhe konsumatorët.

Sipas ligjit të cekur më parë, neni 25, paragrafi 4, thuhet se kryetari dhe anëtarët e tjerë të Komisionit i zgjedh Qeveria nëpërmjet konkursit të hapur dhe ia dërgon Kuvendit të Kosovës për emërim.

Qeveria ka qenë e njoftuar prej Kuvendit që më 25 dhjetor të vitit 2014 se Komisioni i Konkurrencës duhet të plotësohet me të gjithë anëtarët siç ka qenë e njoftuar edhe për ato borde të agjencive të pavarura, të cilat kanë qenë të paplota, apo kanë qenë krejtësisht jofunksionale.

Pyetja ime është kjo: Kur do t'ia dorëzoni Kuvendit listën e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës si strukturë vendimmarrëse e autoritetit të konkurrencës? Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti kryeministër, Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti deputet Qela, I nderuari kryesues,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e kaluar të datës 16 mars ka marrë vendim t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës anëtarët për Bordin e Drejtorëve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Tani me ndryshimin, i cili ka ndodhur në ligjin që e rregullon këtë fushë, Qeveria i propozon drejtpërdrejt dhe nuk ka nevojë të shkohet nëpërmjet sistemit të konkursit.

Unë duhet të ju njoftoj se akoma nuk e kam dorëzuar në Kuvend vendimin e Qeverisë, sepse e kam parë të arsyeshme që të shihen të gjitha rrethanat që asnjë prej kandidatëve të propozuar të mos jetë në kundërshtim me ligjin sa i përket profesionit dhe sa i përket angazhimit politik dhe po ashtu sa u përket kundërthënieve, të cilat mund t'i ketë një kandidat si pronar ose bashkëpronar i ndonjë biznesi, sepse ka kushte shumë të kufizuara dhe rreptësisht të përcaktuara me ligj.

Në qoftë se do të kemi ndonjë ndryshim, ne ndryshimin do ta bëjmë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë dhe menjëherë do t'ia procedojmë Kuvendit emrat e anëtarëve të bordit, përndryshe ne kemi marrë vendim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qela, ke pyetje shtesë? Faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Tashmë u bënë 17 vjet që ka përfunduar lufta në Kosovë dhe çështja e kompensimit të dëmeve të luftës nga Serbia asnjëherë nuk është shtruar në tryezën e bisedimeve me këtë shtet.

Kjo temë do të përfshinte shumë aspekte, që nga shkatërrimi i pronave deri te kompensimi i jetëve të humbura, pra dëmshpërblimi i familjarëve të atyre që janë vrarë dhe zhdukur nga Serbia, dëmshpërblimi i personave apo familjarëve të atyre që janë mbajtur politikisht nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, dëmshpërblimi i grave të dhunuara gjatë luftës, çështja e personave të zhdukur, përfshirë edhe kthimin e të zhvendosurve. Natyrisht këtu duhet të futen të gjitha dëmet e shkaktuara gjatë viteve të aparteidit të viteve të '90-ta, si dëmshpërblimi për investime të humbura në periudhën e okupimit, për humbjet e pagave të personave të përjashtuar nga puna për shkak të përkatësisë kombëtare, për shkatërrimin e sistemit pensional bankar dhe plaçkitjen e kursimeve, për kthimin e kursimeve bankare, dëmet e luftës në pronën publike dhe private dhe objektet e trashëgimisë kulturore dhe një sërë çështjesh të tjera.

Prandaj, i nderuar kryeministër, a keni në plan që në bisedimet që po zhvillohen në Bruksel në nivel kryeministral në përputhje me të drejtën dhe konventat ndërkombëtare të kërkonin nga Serbia reparacione të luftës, disa nga të cilat i përmenda më lart?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit për pyetjen deputete Lama!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Unë konsideroj se çështja që u hap sot këtu nga deputetja është një prej çështjeve tepër të rëndësishme, së cilës ne duhet t'i kushtojmë rëndësi.

Në takimet në Bruksel, në procesin e dialogut, ne e kemi paralajmëruar edhe këtë çështje, si një prej çështjeve të cilën duhet ta diskutojmë dhe një prej çështjeve për të cilën duhet të gjejmë zgjidhje.

Çështja e kompensimit të dëmeve të luftës, që përfshin edhe problemet që deputetja këtu i hapi e që kanë të bëjnë me sistemin pensional dhe plaçkitjen e pensioneve që kanë të bëjnë me bankat dhe plaçkitjen e kursimeve bankare dhe sidomos atyre revizore, të cilat kanë qenë në vitet e '90-ta dhe kthimit të tyre, dëmshpërblimet e drejtpërdrejta nga dëmet e luftës në pronat publike dhe në prona private, në pronat e trashëgimisë kulturore, të cilat ju i keni theksuar këtu, do të jenë çështje të cilat ne do të kërkojmë që të trajtohen në procesin e dialogut.

Ne kemi shtruar disa prej çështjeve që i konsiderojmë që janë me prioritet në dialog, përfshirë edhe këto, përfshirë edhe problemet e të pagjeturve. Mirëpo, kjo është një prej temave që e ka peshën më të madhe.

Prandaj, në këtë proces ne do të kërkojmë që të shqyrtohen. Unë e kam paralajmëruar këtë edhe publikisht, edhe para tri javësh, se është një prej temave që ne do ta diskutojmë, do të kërkojmë kompensime dhe do të kërkojmë që kjo të bëhet në suaza konventave ndërkombëtare.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Zonja Lama, ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Faleminderit!

Siç e thashë, kanë kaluar shumë vite pra që kur ka përfunduar lufta dhe unë si deputete nuk jam e informuar në fakt së paku nga shteti i Kosovës nëse janë bërë vlerësimet deri tani për këto dëme të luftës, domethënë jo nga kjo Qeveri, por ju mund t'i keni trashëguar edhe nga Qeveria e kaluar se çfarë ka ndodhur me vlerësimet, a janë bërë vlerësimet dhe sa mund të jenë këto vlerësime, apo pritet që të krijohen komisione të tjera për t'i dhënë saktësisht këto dëme, të cilat Serbia duhet t'ia kompensojë Kosovës?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë, meqenëse kam qenë vetë pjesë e delegacioneve në bisedat e Vjenës, mund të them se në atë periudhë ne kemi pasur disa vlerësime të punuara në mënyrë të detajuar lidhur me plaçkitjen e pensioneve, lidhur me dëmet që janë bërë në sistemin bankar dhe në sistemin e kursimeve. Ndërkaq nuk mund të them se ka pasur të dhëna shumë të sakta sa u përket dëmeve të luftës.

Prandaj, konsideroj se ato duhet edhe një herë të rivlerësohen dhe të riaktualizohen në pikëpamje kohore dhe në pikëpamje të vlerës së tyre dhe për këtë do të punojmë paralelisht, qoftë komisioni ose qoftë institucionet të cilat mund në mënyrë shumë të saktë të bëjnë ekspertizën e tyre, duke i marrë gjithmonë parasysh edhe të dhënat që ne i kemi punuar atëherë gjatë atij procesi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. A ke kartelë, zonja deputete?

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, për fjalën kryesues!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra, kolegë deputetë,

Çështja që unë do të ngre sot në formë të pyetjes për ministrin e Arsimit, zoti, Arsim Bajrami, është diskutuar disa herë më parë.

Në tekstet shkollore të nxënësve tanë, të siguruara financiarisht nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë gjetur shumë lëshime dhe gabime të natyrave të ndryshme, duke e tejkaluar kështu barazinë gjinore, liritë fetare, shprehjet joadekuate e të tjera.

Këto lëshime janë përmendur edhe në këtë Kuvend, por shumë herë kanë qenë edhe tema debati nëpër forume të ndryshme dhe nëpër media, gjithashtu.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka themeluar një grup punues për korrigjimin e këtyre lëshimeve.

I nderuar ministër Bajrami,

Pyetja ime është: Sa ka arritur të punojë ky grup dhe të sjellë rezultate dhe a do të botohen librat për shtatorin e ardhshëm me korrigjimet e duhura? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër Bajrami, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete Labinotë Demi-Murtezi, Ju falënderoj shumë për këtë pyetje, një pyetje shumë e rëndësishme për ngritjen e cilësisë në sistemin arsimor, sepse jo rrallë kemi dëgjuar shqetësime për cilësinë e teksteve mësimore.

Më lejoni të ju njoftoj që pas shumë viteve, për herë të parë e kemi filluar një shikim thelbësor substancial të të gjitha teksteve parauniversitare nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. E kemi themeluar një grup të nivelit të lartë, të udhëhequr nga zëvendësministrja Anila Statovci, dhe më 31 mars të këtij viti do ta kemi raportin e parë sa i përket gjendjes së teksteve.

Më lejoni të ju informoj se në fazën e parë ne kemi vendosur standarde që duhet t'i kenë tekstet dhe i kemi vendosur 15 standarde pedagogjike profesionale që duhet t'i ketë çdo tekst dhe secili tekst është duke u skanuar.

Shumë shpejt do ta kem në dorë raportin që do ta ndaj edhe me ju, kur do të shohim se si janë këto tekste me standarde. Ju përmend vetëm disa standarde sa i përket gjuhës, sa i përket parimit të jodiskriminimit, sa u përket të drejtave, por ka edhe standarde tjera që tani janë ndërkombëtare, sepse tekstet sot janë ndërkombëtarë dhe janë me standarde ndërkombëtare.

Jemi të vendosur që këtë vit shkollor të bëjmë rishikimin e të gjitha teksteve, por edhe ndërrimin e teksteve për të cilat vërejmë që nuk janë plotësuar këto standarde. Kemi kohë të mjaftueshme.

Kemi vendosur që në mënyrë të veçantë të fokusohemi te katër tekste mësimore: tekstet e historisë për shkollën fillore, tekstet e gjeografisë, tekstet e edukatës qytetare dhe tekstet e gjuhës shqipe, por edhe në tekste të tjera.

Ju garantoj dhe ju siguroj që asnjë tekst nuk do të punohet për vitin e ardhshëm shkollor pa iu nënshtruar këtij verifikimi, që do të shkon në dy nivele.

Niveli i parë që përfundon deri më 15 prill, kur rishikohen standardet e përgjithshme, dhe niveli i dytë kur do të veçojmë disa tekste për të cilat kemi raportime sa u përket standardeve pedagogjike dhe profesionale, në mënyrë që fëmijëve tanë t'ua ofrojmë një edukim pozitiv, një edukim në vlera profesionale, tani dhe në standarde ndërkombëtare, sepse po jetojmë në një kohë ku standardet e teksteve mësimore janë standardizuara në nivel evropian dhe ato po fillojnë edhe në epokën e digjitalizimit.

Sivjet disa tekste do t'i prodhojmë edhe në formë digjitale, në mënyrë që vërtet, sa u përket teksteve universitare, ta shmangim cilindo parregullsi apo dobësi që është shfaqur në vitet e kaluara.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Nuk ka pyetje shtesë deputetja. Faleminderit! Deputeti Bislim Zogaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

BISLIM ZOGAJ: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka bërë një punë të shkëlqyeshme në ndërtimin dhe renovimin e shumë shkollave në Kosovë. Më në fund u bë edhe renovimi i shkollës fillore të mesme të ulët “Xheladin Gashi Plaku” në Komoran.

Tani edhe Komorani e ka një shkollë shumë të mirë, e cila krijon kushte dhe hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin normal të mësimi. Për këtë është mirënjohëse popullata e Komoranit në rrethinën prej nga vij edhe unë.

Por, zoti ministër, tani për shkak të mungesës së inventarit mësimi është duke u zhvilluar në tri ndërrime.

Po ashtu, edhe dhoma për burime është dhomë për nxënësit me aftësi të kufizuara. Për momentin, për shkak të mungesës së inventarit nuk është funksionale.

Pyetja: A është planifikuar nga Ministria që të bëhet inventarizimi i kësaj shkolle, si dhe shkollës fillore të mesme të ulët “Rasim Kiçina” në Drenas, dhe nëse po a mund të shprejsojmë që inventarizimi i këtyre shkollave do të bëhet shpejt?

KRYESUESI: Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Zogaj, ju falënderoj për pyetjen!

Siç ju kam informuar edhe në fillim të këtij mandati qeveritar, Ministria e Arsimit në këtë mandat nuk e ka përgjegjësi ndërtimin e shkollave dhe atë përgjegjësi në bazë të memorandumit të mirëkuptimit e kemi bartur te Ministria e Administratës Publike. Pra, nuk kemi kohë për të humbur sa i përket tenderimit të shkollave, por jemi koncentruar që këtë kohë ta përdorim për ngritjen e cilësisë.

Megjithatë, ne jemi përgjegjës për furnizimin me inventar të të gjitha shkollave në Republikën e Kosovës.

Dhe, më lejoni të ju njoftoj që javën e ardhshme shkolla e Komoranit do të furnizohet tërësisht me inventar. Kemi biseduar me furnitorët dhe gjithashtu edhe shkolla “Rasim Kiçina” në Drenas javën e ardhshme, do të ju ftojme edhe ju, edhe gjithë të tjerët që të marrin pjesë bashkë në aktivizimin e kësaj shkolle, për shkak se Ministria e Arsimit ka investuar në renovimin e këtij objekti, i cili ka përfunduar në një afat rekord.

Gjithashtu, edhe për të gjitha shkollat tjera të komunave të Kosovës e kemi siguruar furnizimin e plotë me inventar, i kemi siguruar edhe pajisjet për shumë laboratore dhe kemi siguruar edhe mjaft donacione të Bashkimit Evropian sa i përket pajisjes me pajisjet e teknologjisë informative.

Pra, secila shkollë në Republikën e Kosovës do të jetë e mirëpritur në Ministrinë e Arsimit që t'i parashtrijë kërkesat për inventar dhe për pajisjet e teknologjisë informative, në mënyrë që vërtet të sigurojmë kushte për një mësimdhënie cilësore.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Zogaj?

BISLIM ZOGAJ: Jo, vetëm dua të falënderoj për zemërsisht se me të vërtetë është bërë një objekt shumë i mirë, një punë shumë e mirë është bërë në atë shkollë, prandaj edhe ky inventarizim do të ishte një ndihmesë dhe me të vërtetë falënderoj nga zemra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

GANIMETE MUSLIU: Zoti ministër!

Kohën e fundit janë raportuar disa probleme që kanë të bëjnë me sjelljet jopedagogjike të mësimit në shkollë.

Kohën e fundit, pikërisht rasti i fundit në shkollën “Rudolf Walther” në fshatin Dobidol në komunën e Rahovecit ku shfaqen pamje shqetësuese që mësimit në godet në mënyrë brutale nxënësin. Kjo dukuri e cila ndikon negativisht në raportet në mes të mësimit dhe nxënësve mund të jetë pengesë në ndërtimin e besimit reciprok, i cili e krijon një imazh të keq dhe e degradon në masë të madhe arsimin në Kosovë. Gjithashtu është një shqetësim permanent i të gjithë qytetarëve të Kosovës, sepse pamjet e tilla alarmojnë dhe shqetësojnë qytetarët. Çka ka ndërmarrë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në lidhje me rastin e fundit dhe a do të kemi raste dhe pamje të tilla që do të na shfaqen sërish nëpër shkollat e Kosovës?

KRYESUESI: Ministër Bajrami, urdhëroni!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete Musliu!

E ndajmë shqetësimin tuaj dhe pa dyshim që dhuna ndaj nxënësve është diçka e papranueshme, diçka joetike. Për fat të mirë, është një dukuri mjaftë e izoluar, por nëse ka edhe vetëm një rast, ai është për shqetësim.

Ju njoftoj që në rastin që ju ngrehët Ministria e Arsimit, nëpërmjet degës së Inspektoratit në Gjakovë ka marrë masa të menjëhershme, ka bërë inspektimin për 24 orë dhe ka shqiptuar masën e menjëhershme të suspendimit për mësimit në fjalë. Ndërkaq, tani rasti është duke u trajtuar edhe në gjykatë dhe ne po e presim epilogun e gjyqimit dhe do të marrim masa, por jemi duke punuar në mënyrë preventive që këto raste të izoluara t’i mënjanojmë tërësisht edhe nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë me drejtoritë komunale të arsimit, sepse kemi vërejtur se një numër shumë i vogël i mësimit, që është gati minor, nuk i plotëson kushtet psikike dhe kushtet pedagogjike për të qenë pjesë e procesit mësues.

Për fat të mirë, ky numër është shumë i vogël, por ne do të punojmë që me këtë grup, që nganjëherë është edhe i moshës së shtyrë, të punojmë me disa trajnime, me disa kurse që këta vërtet të përmirësohen në mësimit, por në qoftë se nuk kemi zgjidhje tjetër këtyre do t’u ofrojmë që të jenë pjesë e stafit profesional, por jo edhe e stafit mësues dhe pedagogjik.

Projekti i eliminimit të dhunës në shkollë është një projekt shumëdimensional që nuk ka të bëjë vetëm me dhunën e vrazhdë që bëjnë mësimit ndaj nxënësve, por edhe në format tjera dhe ne e kemi strategjinë për luftimin e dhunës në shkollë me të cilën po punojmë, jo vetëm në vetëdijësim, por edhe në parandalimin e këtyre dukurive të shëmtuara.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete Musliu, ke pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti ministër!

E thatë edhe ju që janë raste të izoluar, por do të punojmë që të mos e kemi asnjë rast të tillë. Unë kisha edhe një pyetje shtesë, nëse më lejohet: A kemi psikologë nëpër shkollat tona, saktësisht në këtë shkollë ku ka ndodhur rasti a kemi të angazhuar psikolog, dhe psikologët që janë të angazhuar në shkolla a mbajnë seanca edhe me mësimdhënës, apo nëse janë të angazhuar angazhohen vetëm për nxënësit? Pyetjen e bëj më shumë që qytetarët ta marrin një përgjigje, sepse është një çështje që na shqetëson të gjithëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Tani brenda grandit specifik për komuna, që u jepen komunave për arsim, bashkë me ministrin e Financave jemi pajtuar që krahas pedagogëve, shkollat tona të fillojnë të pajisen edhe me psikologë. Njëkohësisht, Ministria e Arsimit është faktori kyç në implementimin e strategjisë kombëtare për luftimin e radikalizmit dhe psikologët janë një mundësi shumë e mirë që të punojmë, jo vetëm me nxënë, por edhe me pedagogë, që vërtet të ndërtojmë standarde.

Nuk mund të premtojmë që të gjitha shkollat menjëherë do të pajisen me psikologë, por jemi të sigurt se jemi në rrugë të mirë që të shkojmë hap pas hapi dhe sidomos shkollat me numër të madh të nxënësve, krahas pedagogut, ta kenë edhe psikologun. Ministria e ka në plan që shkollat ta kenë edhe mjekun, edhe punëtorin social, në mënyrë që ato të jetë një institucion, jo vetëm edukativ, por edhe një institucion human, i cili e ofron plotësisht një arsimim të plotë dhe një ndërtim të personalitetit të nxënësve tanë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Abrashi. Ministri s'është këtu, do ta bësh pyetjen?

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse ministri Abrashi nuk është i pranishëm, po e shfrytëzoj praninë e kryeministrit, nëse jo për një përgjigje, të paktën për një njoftim, ngase çështja është paksa e ndjeshme.

Strehimoret e viktimave të dhunës në familje nuk janë në gjendje të mirë. Personalisht e kam vizituar strehimoren "Liria" në Gjilan, ku nga shkaku i të ftohtit që ka bërë ato ditë, i kishin refuzuar të gjitha viktimat e dhunës për të gjetur zgjedhje personale opsionale nëpër familjarët e tyre. Pakënaqësi kishte shumë, ndërkohë që të gjitha punëtoret e strehimores ishin të licencuara. Ish-kryeministri i vendit, më 2 prill 2014, kishte marrë vendim në mbledhjen e Qeverisë për ndarje të mjeteve financiare në vlerë prej 150 mijë euro në vit në mënyrë proporcionale nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministri e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Këto mjete do të shfrytëzoheshin për nevojat e strehimit, riintegrimin e grave dhe fëmijëve, kompensimin e viktimave, edukimin kundër dhunës në familje, dhe zbatimin e Ligjit 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje. Mjetet nga ministrinë e lartpërmendura është dashur të barten

në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në kodin 006 - kategoria ekonomike transfere dhe subvencione.

I nderuar ministër Abrashi, ky vendim i Qeverisë së kaluar ka qenë i dizajnuar që të përfillet çdo vit për qëllimet e lartpërmendura. Pyetja ime është: Pse nuk po përfillet ky vendim dhe strehimoret po mbeten në gjendje jo të mirë?

KRYESUESI: Ministri Abrashi, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja Demi Murtezi,

Sa i përket shumës së transferuar me vendim të Qeverisë të vitit 2014, ju njoftoj se mjetet janë alokuar nga Ministria e Financave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kjo shumë e mjeteve në mënyrë proporcionale u është shpërndarë tetë OJQ-ve, të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu ka hartuar dhe ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me secilën prej OJQ-ve dhe e ka bërë transferin në vlerë prej 18 750 euro për secilën OJQ, po ashtu edhe për OJQ “Liria” në Gjilan. Me këtë ju konfirmojmë se kjo ka qenë shumë shtesë nga pjesa kontraktore e shërbimeve që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka me secilën prej këtyre OJQ-ve, të cilat në shumë muajore mbështeten mbi bazën e numrit të klientëve që kanë strehimore.

Vlera e mbështetjes mujore arrin rreth 2 500 euro, ndërsa vjetore deri më 30 mijë euro. Sa për informimin tuaj dhe të deputetëve, vlera e përgjithshme e mbështetjes për OJQ “Liria” Gjilan për vitin 2015 është së paku 40 mijë euro dhe mund të shkojë deri në 45 mijë euro, pasi janë ende në procedurë të pagesave. Andaj, jemi të vetëdijshëm se nevojat janë më të mëdha për funksionimin e një strehimoreje regjionale, por gjithashtu për vëmendjen e deputetëve, por edhe të tërë publikut, duhet të sqarojmë se shërbimet sociale, shërbimet sociale janë përgjegjësi e komunave, andaj komunat duhet të bashkëfinancojnë dhe të ndajnë mjete buxhetore për mbulesën e kosto-shpenzimeve të shërbimeve sociale në secilën komunë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zonja deputete Murtezi, ke pyetje shtesë?

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Aktiviteti juaj ka qenë i dukshëm. Qendra “Liria” më përpara i ka pasur punëtorët e palicencuara dhe licencimi i secilës prej tyre në fusha të ndryshme është një bashkëpunim juaji me këto qendra për ne, domethënë e kemi vlerësuar. E kam shtruar këtë çështje edhe më herët.

Në ditën që unë ua kam adresuar këtë pyetje, më 15 mars, kam marrë një informatë shtesë edhe nga qendra “Strehimorja” këtu në Prishtinë, ku momentalisht ndodhen pesë nëna me fëmijët e tyre, të gjitha viktimat të dhunës nëpërmjet koordinatores së kësaj qendre. Përveç se jemi

informuar se ato nuk paguhen me rregull, ose ka disa muaj që nuk paguhen, kushtet e tyre të jetesës brenda kësaj qendre janë të rënda. Disa herë ka ndodhur që ato të ushqehen vetëm një herë gjatë ditës.

Ne e mirëkuptojmë kontributin tuaj në vazhdimësi, vetëm për hir të korrektësisë dhe bashkëpunimit që kemi me të gjithë qytetarët, edhe me këto qendra, dëshirojmë informata shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit deputete Demi Murtezi,

Është shumë e rëndësishme që po trajtohen këto tema dhe ta përmend edhe një fakt se realisht ne jemi ballafaquar me këto probleme dhe kërkesa të shumta të organizatave që ofrojnë shërbime sociale, por së bashku në Qeverinë, përkatësisht edhe me ministrin e Financave e kemi marrë një iniciativë të cilën po mendojmë që gjatë këtij viti, me plotësim-ndryshimin e Ligjit për financat lokale publike, përfundimisht ta sqarojmë dhe të krijojmë qëndrueshmëri financiare për të gjitha organizatat që ofrojnë shërbime sociale.

Ajo që po tentojmë të bëjmë është se ashtu si komunat që e kanë grantin specifik për arsim dhe shëndetësi, ne ta paraqesim me këtë plotësim-ndryshim të ligjit edhe grantin specifik për shërbimet sociale. Besoj që gjatë vitit 2016 do të kalojë edhe në Kuvend, sepse veç kanë filluar procedurat dhe nga viti 2017 do të ndryshojë gjendja, në mënyrë substanciale në gjithë territorin e Kosovës, sepse secila komunë do ta ketë grantin specifik për shërbime sociale dhe nëpërmjet saj mund të bëjmë edhe kontraktimin, qoftë të strehimoreve, qoftë organizatave tjera që ofrojnë shërbime sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zotërinj deputetë, koha e paraparë për këtë pikë të rendit të ditës ka kaluar, por meqë i kemi edhe katër pyetje, a pajtoheni t'i vazhdojmë? Faleminderit!

Deputetja Mexhide Mjeku Topalli, pyetje për ministrin Abrashi.

MEXHIDE MJEKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Çështja që unë do ta ngre sot është se Ligji nr. 04/L-092 për personat e verbër, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2012, nuk po gjen zbatim të mjaftueshëm - neni 6 i këtij ligji që i përcakton lirimet nga taksat dhe tatimi, neni 13 që i përcakton lirimet nga udhëtimi dhe neni 14, që i përcakton shpenzimet e energjisë elektrike. Pyetja ime, i nderuar ministër është: A keni nxjerrë akte nënligjore që i obligon ligji dhe cilat janë masat, të cilat janë marrë, në mënyrë që ky ligj të gjejë zbatim ashtu siç e meriton? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Abrashi, urdhëro!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,
Kryeministër,

Kabinet qeveritar,
Deputetë,

E nderuara zonja deputete Mjeku-Topalli,

Ligji nr. 04 / L -092 për personat e verbër ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2012. Sipas nenit 25, ligji në fjalë ka filluar të zbatohet prej vitit 2013. Sipas dispozitave të ligjit, MPMS-ja dhe institucionet tjera i kanë nxjerrë aktet tjera nënligjore sa i përket zbatimit të ligjit. Në kuadër të obligimeve të dala nga ky ligj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e drejtë të këtij akti nënligjor i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij ligji.

Ministria e ka miratuar Rregulloren nr. 02/2013 për funksionimin e Komisionit Mediko-Social sipas nenit 17, paragrafi 2 të Ligjit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sipas kësaj rregulloreje, deri më tani nga Komisioni Mediko-Social, zyra e mjekëve, janë trajtuar 2 430 persona. Prej tyre kategoria e parë janë 1 448 persona për pesë vjet, kategoria e dytë 543 persona për tre vjet, të refuzuar janë 439 nga ata.

Në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-092 për personat e verbër, nga MPMS-ja nuk është paraparë dhe nuk është obliguar që të nxjerrë ndonjë akt tjetër nënligjor për zbatimin e këtij ligji, përveç rregullores së lartpërmendur, e cila është miratuar me kohë dhe që është kompetencë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Ligjit për të verbër.

Duke u zbatuar për këto po flasin vetë shifrat e përfituesit nga këto ligje, ndërsa nenet të cilat i keni theksuar, siç janë nenet 6, 13, 14, janë nene të cilat janë kompetencë të ministrive tjera, përkatësisht Ministrisë së Financave, Doganave, Komunave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mund të ndihmojë ose asistojë gjatë këtij procesi.

Sa për informim, sponzorizuesi i këtij ligji ka qenë Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

KRYESUESI: Zonja deputete Topalli, ke pyetje shtesë? Jo! Faleminderit! Deputetja Njomza Emini, pyetje për ministrin Abrashi.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryeministër Isa Mustafa dhe ju ministra të pranishëm,

Të gjithë ne si deputetë dhe ju si ministra shpeshherë si mjet transporti përdorim “taxi”. Unë si deputete kam pranuar ankesa të shumta nga shoferët e kompanive të taksive, të cilët ankohen se nuk kanë kontrata pune, punojnë me orar të stërzgatur, për pushimet vjetore, shëndetësore etj.

Po ashtu, kam pranuar edhe ankesa nga punëtorët e kompanive të pastrimit dhe restoranteve, sidomos të atyre kompanive që shërbejnë nëpër institucionet publike, se nuk kanë kontrata pune, nuk kanë të drejtë pushimi dhe të drejta të tjera që parashihen me Ligjin e punës. Pyetja për ju, ministër i nderuar, është: A u ka bërë Inspektorati i Punës ndonjëherë inspektim apo vizitë të këtyre kompanive për të vlerësuar se sa respektohet Ligji i punës dhe nëse këta punëtorë kanë kontrata, si dhe a është rroga e tyre në përputhshmëri me pagën minimale?

Pra, në mungesë të mbrojtjes formale nëpërmjet kontratës, punonjësit shpeshherë detyrohen të punojnë me orar të zgjatur edhe në festat zyrtare, pa i pranuar kompensimet adekuate shtesë që parashihihen me Ligjin e punës. Pushimet mjekësore, pushimi vjetor dhe të drejtat e tjera të garantuara me legjislacionin përkatës raportohen se shkelen në vazhdimësi nga punëdhënësit kosovarë.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Deputetë,
Deputete Emini,

Ju njoftojmë se Inspektorati i Punës, bazuar në kompetencat që jep legjislacioni në fuqi, realizon inspektime të rregullta të përsëritura me kërkesë të palës, e cila konsideron që janë shkelur të drejtat, si dhe në bashkëpunim me institucionet tjera, të cilat e mbikëqyrin zbatimin e ligjeve.

Rrjedhimisht, Inspektorati i Punës realizon inspektime për çdo ankesë që secila palë mund të ketë ndaj punëdhënësit dhe brenda afatit ligjor i kthen përgjigje me shkrim duke ndërmarrë hapat ligjorë. Mbi këtë bazë, Inspektorati i Punës ka realizuar inspektime edhe në kompanitë e taksive dhe kompanitë tjera që ofrojnë shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes. Në të dyja rastet, Inspektorati i Punës ka hasur në mosrespektim të të drejtave të punëtorëve dhe në të dy sektorët ka shqiptuar gjoba, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, në të dy sektorët, Inspektorati i Punës ka evidentuar specifika kur në rastin e taksive shoferët kanë të lidhur edhe marrëveshje për kompensim monetar, pagë sipas realizimit që bëjnë me punën e tyre dhe rrjedhimisht të tentojnë të përfitojnë sa më shumë. Ndërsa, kompanitë e pastrimit dhe mirëmbajtjes, sidomos kur është fjala në ato kompani që kryejnë shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes në sektorin publik, sidomos atë shtetëror, Inspektorati i Punës ka vërejtur që problemi themelor është te çmimi i tenderit që këto kompani si operatorë ekonomikë ofrojnë në tenderimin për institucionet publike dhe me këtë çmim e fitojnë tenderin.

Shumë shpesh kur këto çmime janë të tilla, ashtu që kompanitë e pastrimit dhe mirëmbajtjes nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet minimale për ta kryer punën, përfshirë edhe pagat minimale, natyrisht mandati i Inspektoratit të Punës është mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit dhe në rastet e tilla Inspektorati i Punës ka shqiptuar gjoba dhe i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për eliminimin e këtyre shkeljeve ligjore. Sa u përket kontratave të punës te këto dy kategori, qoftë të taksive, qoftë te ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes, kontratat e punës për punëtorët qëndrojnë relativisht mirë.

KRYSUESI: Zonja deputete, faleminderit. Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuar kryeministër,
Ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës nëpërmjet politikave të saj duhet ta krijojë një ambient të përshtatshëm për zhvillim dhe operim normal të bizneseve, një mjedis të favorshëm për investime private vendore dhe për investime më të mëdha nga jashtë, duke i lehtësuar kushtet dhe eliminuar barrierat dhe procedurat burokratike, e po ashtu sundimi i rendit dhe ligjit të jenë në funksion të mbrojtjes së bizneseve dhe investimeve, sepse nuk mund të ketë sistem të mirëfilltë ekonomik pa sundim të rendit dhe ligjit.

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizatat financiare ndërkombëtare dhe ato vendore, si dhe analizave të reja nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për rajonin janë identifikuar një varg pengesash për një mjedis së shëndoshë të biznesit, por më të theksuara janë: konkurrenca e pandershme, si dhe fenomeni i informalitetit dhe korrupsionit që janë në nivel të lartë, e që ndikon negativisht në ekonominë e vendit. Ky nivel i lartë i këtyre fenomeneve rrezikon rritjen ekonomike dhe frenon investimet e jashtme. Pyetja për ju, zoti ministër, është kjo: Në cilën masë është shkalla e informalitetit sot në Kosovë, nëse keni ndonjë analizë nga ministria të cilën ju e drejtoni? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër Hoti, urdhëroni!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Faleminderit për pyetjen, zoti Ymeri!

Më lejoni të ju informoj edhe për nivelin e ekonomisë joformale në nivel botëror në regjion dhe në Kosovë. Të dhënat e fundit tregojnë, që në nivel botëror ekonomia joformale është rreth 33% e bruto-produktit të përgjithshëm botëror, në vendet e BE-së kjo sillet rreth 18,5% janë të dhënat e fundit, që i kemi marrë pas pyetjes që ju e keni bërë. Në vendet e regjionit sillen nga 23-38,8% ,varësisht prej vendit. Kalkulimet e fundit që i kemi për Kosovë janë të vitit 2014 nga organizata ndërkombëtare, nga një projekt i Bashkësisë Evropiane, të cilat tregojnë që ekonomia joformale në Kosovë është 31% e që sillet pak a shumë në nivelin e ekonomisë joformale që është në regjion.

Ne e kemi tani një strategji për luftimin e ekonomisë joformale dhe luftimi i ekonomisë joformale në fakt është prioritet në kuadër të programit të Qeverisë 2015-2018. Në Qeverinë paraprake është aprovuar kjo strategji për periudhën 2015-2018 dhe ne tani në baza vjetore jemi duke e rijësuar planin e veprimeve për luftimin e ekonomisë joformale.

Më lejoni të them, që ekonomia joformale është e dëmshme për Buxhetin e shtetit, sepse na i zvogëlon të hyrat, por është e dëmshme edhe për bizneset, sepse shtrembëron konkurrencën e drejtë dhe lokale.

Qëllimet e strategjisë, të cilën sapo e përmenda, është që të reduktojë shkallën e ekonomisë joformale për 5% gjatë periudhës 2015-2018 dhe si rezultat të kemi të hyra buxhetore shtesë për tre vjetet e ardhshme në vlerë prej 66 milionë deri në fund të vitit 2018 vetëm si rezultat i luftimit të ekonomisë joformale. Gjithashtu, një objektiv tjetër është që të rrisim edhe vlerën e konfiskimit të pasurisë dhe të mallrave, si rezultat i aktivitetit informal. Ne kemi tani një plan

konkret për luftimin e ekonomisë joformale, bazuar në strategjinë që e përmenda më herët dhe në baza të rregullta jemi duke bërë vlerësimin e rrezikut kombëtar, që vjen nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Kemi planin e veprimit të strategjisë 2015-2018, që e diskutojmë bashkë me partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe kemi ndërtuar një platformë të komunikimit të rregullt të të gjitha institucioneve që janë pjesë e luftimit të ekonomisë joformale të pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit.

Në Ministrinë e Financave, ju e dini, e kemi aprovuar një pako të ligjeve fiskale dhe një element i rëndësishëm i këtyre ligjeve është luftimi i ekonomisë joformale. Atë që jemi munduar ta bëjmë përmes këtyre ligjeve është që të krijojmë insentivë për biznese, që ta gjejnë më të lehtë të operojnë në sektorin formal dhe besoj që kjo ka dhënë rezultate. Të dhënat që ne i kemi nga muaji janar 2015 deri në mars të këtij viti 2016 janë 4 364 punëtorë që kanë kaluar nga ekonomia, nga punësimi joformal në punësimin formal, që janë paraqitur në Administratën Tatimore të Kosovës. Gjithashtu, unë i kam bërë publike edhe të dhënat sa u përket të hyrave buxhetore, që i kemi mbledhur gjatë vitit të kaluar.

Ne vlerësimet na tregojnë që kemi pasur një rritje ekonomike, që është mbi 3%, ndërkohë që të hyrat buxhetore janë rritur me mbi 9%, pra trefish më shumë se sa që ka qenë rritja ekonomike reale në vend, që nënkupton inkasim i të hyrave nga zvogëlimi i ekonomisë joformale. Ne do të vazhdojmë me këto aktivitete, në baza vjetore do ta rijësojmë planin e punës për luftimin e ekonomisë joformale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti Ymeri, veç mos e zgjat, se ministri e zgjati një minutë, bëhu preciz!

AVDYL YMERI: Faleminderit!

Ministër, së pari dua të ju përgëzoj për disiplinën financiare, që po tregoni me paranë publike, mirëpo mua më interesojnë hapat konkretë që do të ndërmerri, në mënyrë që shkalla e informalitetit të jetë në nivelin apo shkallën e lejuar dhe a ka ndonjë kompani që është më e përkrahur dhe më e privilegjuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Hoti e ka fjalën.

ABDULLAH HOTI: Po tani, përveç koordinimit që e bëjmë me të gjitha organet e rendit dhe të Ligjit, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe takimet e rregullta që i kemi me të gjithë aktorët, që menaxhojmë këtë njësi, ju e dini për projektin që e kemi pasur për mbledhjen e kuponëve fiskalë. Jemi munduar që t'i involvojmë qytetarët në zvogëlimin e ekonomisë joformale. Dhe, kjo ka dhënë rezultate. Janë mbi 1 milion kuponë fiskalë, që në baza tremujore dorëzohen në Administratën Tatimore dhe i riimbursojmë. Tani është krijuar një vetëdije shumë më e madhe e qytetarëve për rëndësinë e pagesës së taksave për shtetin.

Ka plot qytetarë që nuk blejnë më nga biznese që nuk lëshojnë kuponë fiskalë, e që nuk janë pjesë e ekonomisë formale të vendit.

Para dy ditësh ka qenë një aksion, që në fakt ka qenë aksioni më i madh për shumë kohë, i ndërmarrë nga Dogana e Kosovës dhe nga Policia e i mbështetur gjithashtu edhe nga organet e tjera, për luftimin e kontrabandës dhe evazionit fiskal. Mendoj, se këto janë hapat konkretë që ne jemi duke i ndërmarrë në baza të rregullta për luftimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Hoti! E kemi edhe një pyetje, por ministri nuk është këtu. Zonja Emini, do ta lexoni atë pyetje? Jo?! Faleminderit! Atëherë, ju njoftoj që pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Nëse keni vërejtje për procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 10 mars dhe 15 mars? Nuk ka vërejtje. Konsideroj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 10 mars dhe 15 mars 2016.

Atëherë, para se të kalojmë në rend dite, fjalën e ka kërkuar Selville Halimi.

SELVILLE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pajtim me nenin 42.2 të Rregullores së Kuvendit Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kryetarit të Kuvendit i paraqet propozim që të plotësohet rendi i ditës i mbledhjes plenare të Kuvendit më datë 24 mars 2016 me pikën e re të rendit të ditës:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 si dhe Ligjin 04/L-115.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 42, pika 2 të Rregullores së Kuvendit Komisioni mund të propozojë me shkrim kryetarit të Kuvendit një amendament për rendin e ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit. Duke pasur parasysh faktin se propozimi për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes plenare të Kuvendit konsiderohet si çështje e ngutshme, komisioni propozon amendament për plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare 24 mars 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: E kemi një propozim për një pikë të rendit të ditës dhe, natyrisht, duhet të vendosim këtu në seancë. Le të deklarohen më së pari për këtë propozim shefat e grupet parlamentare. LDK, shefi i grupit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne mbështesim këtë propozim, gjegjësisht kërkesë që të plotësohet rendi i ditës me pikën që e tha zonja Halimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të PDK-së, shefi i grupit Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë propozim.

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë tutje, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, “Nisma” dhe... ajo është... po i përmend, por s’janë këtu. Lista serbe, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući! I poslanička grupa Srpske liste podržava ovaj predlog.

KRYESUESI: Nga Grupi “6+”?

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim. Verilen öneriyi “6+” Parlamenter Grubu da desteklemektedir.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete për “6+”! Nuk ka të tjerë. Atëherë, grupet pajtohen që të votojmë sipas rregullit, për ta futur në rend dite kërkesën që e shtroi zonja Halimi. Kini kujdes, këtu janë dy-tri kërkesa, ne duhet të vendosim a po e vendosim një herë me e trajtua, mos u ngutni. Keni kohë ta trajtoni të plotë kërkesën.

Pra, sa deputetë i kemi? Në sallë i kemi 70 deputetë. Kur të jetë vendimi i vlefshëm, të votojnë 2/3-at e atyre që janë të pranishëm. Votojmë tash!

Me 59 vota për, 5 abstenime, 1 kundër, votohet për, se duhen 46, domethënë kalon. Hyn si pikë e rendit të ditës kërkesa e shtruar nga komisioni.

Atëherë, kalojmë në paraqitjen e kësaj pike të rendit të ditës. A për rend të ditës edhe një kërkesë!? Gjithmonë për rend të ditës, kërkesë tjetër, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë edhe në emër të shefit edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkoj që pika e 10-të të renditet pas pikës 4 dhe kjo pika tjetër që u shtua 5-shi, edhe kjo le të jetë pika e 6-të e rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare, grupi i PDK-së, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Edhe Grupi Parlamentar i PDK-së i jep përkrahje këtij ndryshimi, pra radhitjes së kësaj pike në pikë të dytë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Pra, kemi të bëjmë me ndërrim, pika është në rend dite, por kalohet të trajtohet më herët. Sasha Milosavljeviq, në emër të Listes Serbe.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpske liste podržava i ovaj predlog da 10-a tačka bude posle 4-e.

KRYESUESI: Grupi “6+”, e dëshironi fjalën? Mufera Shinik, urdhëro!

MÜFERA ŞINIK: Aynı şekilde “6+” Parlamenter Grubu da desteklemektedir.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ky është një pëlqim i përgjithshëm formal, ndërrimi prej pikës 10 kalohet, po më duket i bie e 6-ta tash kur e futëm edhe këtë tjetrën. Dhe tani, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, që bëhet:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-033

Komisioni funksional në pajtim me vendimin e Kuvendit ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin e Drejtësisë, Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit, profesor Hamiti!

I nderuari kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes para jush për ndryshim Projektligjin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, i cili ka për qëllim që të bëjë ndryshimet adekuate pas asaj që kemi bërë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që kemi dhënë mundësinë që shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të zgjidhen nga vetë radha e gjyqtarëve. Besoj që me këtë ndryshim po e rrisim fuqinë e Këshillit Gjyqësor në Republikën e Kosovës.

Më lejoni të them, që me këtë ndryshim, respektivisht në nenin 20 të këtij projektligji do të ndryshohet çështja që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër për një periudhë të arsyeshme kohore, në raste kur gjykata tjetër ka një numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e lëndëve. Po ashtu, më lejoni të them, se sipas këtyre dispozitave transferimi i gjyqtarëve do të mund të bëhet edhe me miratimin paraprak të kryetarit të gjykatës përkatëse.

Unë mund të konstatoj këtu, se do të nxirret një rregullore e veçantë e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, e cila do të rregullojë në detaje këtë transferim.

Më lejoni të them, se heq hamendjen apo do të thosha, të kem vëmendjen tuaj, se transferimi i gjyqtarëve nga një gjykatë tjetër nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre paraprak. Pra, edhe në rastin konkret, në ligjin që duhet ta themi këtu, nga se është kategori kushtetuese, transferimi të jetë me pëlqimin paraprak të gjyqtarëve, e kundërta mund të bëhet vetëm me masa disiplinore, pra neni 20, ku thuhet “mund të jetë me pëlqimin e kryetarit të Gjykatës”, mund të shtohet fjala “... edhe me pëlqimin e gjyqtarit kompetent”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër i Drejtësisë!

Tani e kemi radhën e diskutimeve. Nënkyetarja e Komisionit për Legjislacion, zonja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2016, shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 si dhe Ligjin nr. 04/L-115 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

1. Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115;

2. I rekomandohet Kuvendit shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115;

Shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet që në seancën plenare të datës 24.3.2016 dhe gjithashtu, shqyrtimi i dytë të bëhet në seancë të re plenare në ditën e sotme, pra më 24.3.2016.

A r s y e t i m:

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit para shqyrtimit të parë të Projektligjit, në mbledhjen plenare, Komisioni Funkcional e shqyrtoi Projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 05/L-033 si dhe Ligjin numër 04/L-115, vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni po ashtu, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, për shkak të natyrës urgjente të procedimit të Projektligjit që ka të bëjë me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave për Kosovën respektivisht krijimin e bazës ligjore për t'i mundësuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të bëjë transferimin e gjyqtarëve duke hequr kufizimin kohor prej 6 muaj sa është aktualisht, Komisioni vlerësoi se ky transferim i gjyqtarëve do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor.

Andaj, duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni i rekomandon Kuvendit të bëjë shmangie të Rregullores së Kuvendit dhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-223 për Këshillin gjyqësor të Kosovës, si në leximin e parë edhe në leximin e dytë të shqyrtohet më 24.3.2016 në dy seanca plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me diskutimin e ligjit. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë radhën. Për Grupin e PDK-së, Nait Hasani.

NAIT HASANI: Jam në emrin tim, jo në emër të Grupit!

KRYESUESI: Agim Aliu, a është në emër të Grupit? Atëherë, urdhëro Aliu!

AGIM ALIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin dhe kërkon nga deputetët e Kuvendit që ta mbështetin, si dhe do ta japë kontributin e vet gjatë grupit punues në mes të dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin e LDK-së, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!
Për ne, si Grup parlamentar, mbetet e rëndësishme vizioni për rritjen e numrit të gjyqtarëve, apo krijimi i mundësive, qoftë nga Këshilli Gjyqësor, por edhe nga Ministria e Financave.

E dyta, sa u përket propozimeve, vetë nga emërtimi i Projektligjit shihet se ky projektligj është ndryshuar kohë pas kohe me të vetmin qëllim që të rritet edhe efikasiteti dhe efektiviteti në sistemin gjyqësor.

Sa i përket nenit të propozuar, ne mendojmë se duhet të japim përkrahje në parim, por si do që të jetë, edhe në këtë kohë të shkurtër në mes të këtyre dy leximeve ajo që e përmendi edhe Ministri të çështja e transferimit jo vetëm mënyra e marrjes së pëlqimit të gjyqtarëve por për mua dhe Grupin Parlamentar mbeten të rëndësishme kriteret, kritere të cilat do të rregullohen me rregulla të brendshme të KGJK-së.

Në këtë fazë, ne në Komision bashkërisht do të shikojmë që ta saktësojmë mënyrën dhe të mos ketë dilema apo edhe të mos ketë, kushtimisht e them, ndonjë keqpërdorim eventual në kryerjen e detyrave, sepse jo çdo herë përshtatet mënyra e lëvizjes së gjyqtarëve edhe në cilësinë e peshës së veprave por edhe në kohën dhe në rrethanat në të cilat zhvillohen gjykime, kështu që ne e japim përkrahjen në parim dhe do të kontribuojmë sipas mundësive tona dhe kapaciteteve që i kemi bashkërisht edhe me grupet tjera të interesit për ta saktësuar mënyrën më të mirë të lëvizjes së këtij afati kohor. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash i kemi deputetët! Nait Hasani e ka fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!
Është një ligj që ka ardhur, mund të them, me rëndësi por për ta saktësuar këtë çështje mund të them se sistemin e drejtësisë në Kosovë e kemi pikërisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Gjendja e gjyqtarëve, e lëndëve, e tmerrit nëpër gjykata, është pikërisht Këshilli Gjyqësor dhe forma e përcudnimit të tillë të këtij projektligji, vënia e përgjegjësive po ashtu e Këshillit Gjyqësor në një formë të tillë, tregon ikje nga përgjegjësia dhe bartje e lëndëve apo mbulimi i lëndëve të cilat janë në përgjegjësi.

Kërkesa që të ndërrohet afati kohor prej 6 muajsh dhe të kalohet në një kohë të arsyeshme, që do të thotë e pa përcaktuar, që do të thotë se mund ta transferojë një gjyqtar pa dëshirën e tij, pa pëlqimin e tij, që është një kategori kushtetuese dhe që e përmendi edhe ministri, ta çojmë në një gjykatë tjetër dhe ta lëmë në mënyrë të përhershme.

Kjo do të thotë sikur kur duhet t'i bartim atje, se ne nuk na pëlqen gjyqtari, nuk i kryen detyrat mirë, nuk i përzgjedh mirë, dhe në vend që të marrim masa të suspendimit nëse ka nevojë, masa të përjashtimit nëse ka nevojë, ne e bëjmë një transfero dhe e çojmë, ta zëmë, në Podujevë, në Gjilan apo diku tjetër, dhe mbajmë në forma të tilla me vite të tëra.

Afati i kufizuar ka qenë mundësia e ndihmesës për 6 muaj nëpër gjykata, ku ka nevojë të shkohet, por të shkohet në afatin e pa përcaktuar kjo do të thotë se është një shkelje e procedurave.

Në nenin 20, që është kërkuar të ndryshohet, askund nuk përcaktohet, për shembull forma...

Afati periudhë kohore. Nëse ka 6 muaj... a e ka pëlqimin apo mospëlqimin, a është kategori kushtetuese. Vendet e punës hapen për vendet e përcaktuara në objektet ose vendet e punës ku është, në gjykatat e Prizrenit apo në gjykatën e Prishtinës apo nëpër tjera gjykata. Nuk hapet vendi i punës në Prishtinë dhe transferohet në Mitrovicë apo të hapet në Prishtinë dhe të transferohet në Ferizaj, apo diku tjetër.

Hapja e vendit të punës është pikërisht për vende, prandaj nëse nuk e ka një përcaktim kohor, nëse nuk e ka një përcaktim të pëlqimit pa pëlqimin e tij nuk mund të bëhet bartja, atëherë është e arsyeshme të hyjë, përndryshe kjo është mundësia e lirimit të korrupsionit në formën e heshtjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë që dëshirojnë të diskutojnë për këtë projektligj. Ju lutem, të dimë numrin e deputetëve të të pranishëm!

Deputetë të nderuar, ju lutem do të votojmë dhe uluni, të votojmë. Atëherë, ju lutem saktësisht dëgjoni çka po kërkoj. Ne e kemi leximin e parë dhe do ta votojmë leximin e parë të këtij ligji dhe tutje është dhe një kërkesë tjetër që të ketë edhe lexim të dytë, por për atë duhet të vendosim a do të mbahet edhe një seancë veçantë sot për lexim të dytë.

Tash e vë në votim këtë ligj në leximin e parë dhe votojmë tash!

Me 62 vota për, 3 abstenime dhe 2 kundër, kalon në leximin e parë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-115 dhe me Ligjin numër 05/L-033.

Tash Komisioni ka propozuar, për shkak të nevojave dhe urgjencës që të hyjë sa më shpejt të bëhet ligj i votuar tërësisht dhe të caktohet, thotë komisioni, një seancë sot. Dhe ju e dini, pa u krye kjo seancë e sotme, s'ka seancë tjetër. Do të thotë e qes në votim kërkesën që leximi i dytë i këtij ligji të bëhet në një seancë të veçantë sot.

64 deputetë jemi të pranishëm. Ju lutem, duhet të votojnë 2/3.

Tash janë të pranishëm 68 deputetë dhe votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë. 63 janë për, 2 abstenojnë dhe 2 kundër dhe Kuvendi vendosi që të caktohet sot një seancë e re në mënyrë që të bëhet leximi i dytë i këtij projektligji. Faleminderit!

4. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 21 mars 2016, në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës ia ka parashtruar Kuvendit propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe 2 anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Kryetari i Kuvendit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendi t'i propozojë 3 gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka propozuar 3 gjykatës të cilët do ta përbëjnë Organin Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Atëherë, kërkojmë deklarinimin e kryetarëve ose të përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Nuk doni të merrni fjalën?

Atëherë, të propozuar janë:

- Gultene Sylejmani nga Gjykata Supreme e Kosovës,
- Nenad Laziq nga Gjykata e Apelit e Kosovës dhe
- Afërdita Bytyçi nga Gjykata Themelore e Kosovës.

I thashë emrat dhe tash më lejoni të procedoj me seancë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për formimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe votojmë tash:

Në votim kanë marrë pjesës 67 deputetë. 65 janë për, 2 abstenojnë, kundër nuk ka dhe ju njoftoj se Organi përzgjedhës i pavarur u zgjodh për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në përbërje:

- Gyltene Sylejmani,
- Nenad Laziq dhe
- Afërdita Bytyçi.

Ngarkohet organi përgjegjës i pavarur që në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurimin publik ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe 2 anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Kuvendit t'i paraqet raport me rekomandime.

Atëherë kërkohet nga organi përzgjedhës i pavarur që raportin me rekomandime t'ia paraqet Kuvendit jo më vonë se më 30 mars 2016.

Propozoj që seanca plenare të propozohet për emërimin e kryesuesit dhe 2 anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik të mbahet më 30 mars 2016, në orën 11:00.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin për mbajtjen e kësaj seance për këtë çështje.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Atëherë konstatoj se Kuvendi vendosi që seanca plenare për këtë çështje të mbahet më 30 mars 2016 në ora 11 me rend dite:

- Emërimi i kryesuesit dhe i 2 anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Faleminderit!

Tash kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës, që me votën tuaj u tërheq më herët dhe u bë pikë e gjashtë e rendit të ditës:

10. Emërimi i një anëtari të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për 1 anëtar të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërtimin e njërit prej dy të propozuarve:

- Ismet Hashani dhe
- Avdi Konjuhi.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, si propozues të çështjes të marrë fjalën! Nuk do Qeveria të artikulohej për këtë çështje.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Na e kemi paraqitur raportin dhe nuk kemi çka t'i shtojmë raportit.

KRYESUESI: Do të thotë, edhe Komisioni nuk ka fjalë shtesë, pos raportit. Kërkoj artikullimin, nëse duan normalisht, e kryetarit ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare të marrin fjalën. Për LDK-në është paraqitur kryetari i Grupit Ismet Beqiri. Urdhëroni! Nuk doni ta merrni fjalën!

Atëherë, grupet tjera, a donë të marrin fjalën? Nuk duan.

Deputetët? Nuk duan!

Të nderuar deputetë,

Meqë janë propozuar 2 kandidat për 1 pozitë, atëherë duhet të mbahet votimi i fshehtë.

Për zbatimin e procedimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve në mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga 1 antëar për Komisionin votues. Nga Grupi i PDK-së Adem Grabovci, shef i Grupit! Urdhëroni!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon zotëriun Hajdar Beqa për anëtar të këtij komisioni shumë të rëndësishëm, dhe njëkohësisht të jetë kryetar.

KRYESUESI: PDK propozon Hajdar Beqën. LDK? E ka fjalën Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Ne e propozojmë zotin Salih Morina.

KRYESUESI: Faleminderit, është Salih Morina për LDK. "Vetëvendosje"? AAK, Lista serbe?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Mi predlažemo eksperta za ovakve vrste komisije, Adema Hodžu!

KRYESUESI: Është propozuar Adem Hoxha për Listën serbe! Mufera Shiniq për Grupin "6+".

MUFERA SHINIK: Grupi Parlamentar "6+" e propozon deputetin Qerim Bajrami.

KRYESUESI: Qerim Bajrami për Grupin "6+".

KRYESUESI: Atëherë, ju lutem me ngritje dore, le të emërohet Komisioni votues. Kush është për, a ka kundër? Një është kundër. Faleminderit! A abstenon dikush? Nuk ka abstenim. Me shumicë votohet, një kundër, asnjë abstenim.

Tash e lus komisionin që të fillojë me procedimin dhe të ftohen deputetët sipas listës. Komisioni le ta fillojë punën e vet.

Fillojmë me votime, ju lutem!

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Syla, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj Gutaj, Margarita Kadriu Ukelli, Melihate Tërmkollë, Mexhide Mjaku Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emmini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: Komisioni fillon numërimin e votave. Urdhëroni!

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Atëherë, fillojmë me procesin e numërimit:

Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Ismet Hashani,
Avdi Konjuhi,
Ismet Hashani,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Ismet Hashani,
Ismet Hashani,
Ismet Hashani,
Avdi Konjuhi,
Ismet Hashani,
Ismet Hashani,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,

Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Avdi Konjuhi,
Ismet Hashani,
Avdi Konjuhi,
E pavlefshme,
Avdi Konjuhi, dhe e fundit,
Avdi Konjuhi.

KRYESUESI: Atëherë, të dëgjojmë raportin e Komisionit votues. Urdhëro, zoti Morina!

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni votues për zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera e Minerale konstaton se:

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 1 anëtari të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera e Minerale, në seancën plenare të mbajtur më 24 mars 2016, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 72 deputetë;
- Të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale janë, si në vijim:

1. Ismet Hashani i ka fituar 18 vota dhe
2. Avdi Konjuhi i ka fituar 49 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 95.5 të Ligjit numër 03/L-163 për miniera e minerale dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Avdi Konjuhi emërohet anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me mandat 5-vjeçar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Morina!

Atëherë në bazë të raportit të Komisionit votues, konstatoj se Kuvendi e emëroi zotin Avdi Konjuhin anëtar në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me mandat 5-vjeçar.

Me kaq i përmbyll punimet e paradites së seancës. Seanca tjetër, pas pushimit të drekës, fillon në orën 15:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Po vazhdojmë me rendin e ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, zoti Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës ligjore në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane për fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, e veçanërisht në shfrytëzimin e mekanizmave për parandalimin e ndotjes së mjedisit në Republikën e Kosovës, para nesh e kemi Projektligjin për mbrojtje nga zhurma.

Duke pasur parasysh vështirësitë në implementimin e ligjit në fuqi, si dhe duke pasur parasysh faktin se ligji në fuqi nuk ka qenë në përputhshmëri me legjislacionin përkatës të Bashkësisë Evropiane me ‘acquis communautaire’, Qeveria e Kosovës ka marrë qëndrim që ta ndryshojë dhe plotësojë Ligjin ekzistues numër 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma.

Gjatë përgatitjes së këtij projektligji janë marrë në konsideratë rekomandimet dhe sugjerimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe në veçanti janë marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Funkcional të Kuvendit të Kosovës në mandatin e kaluar, të përgatitura në procesin e amendamentimit të projektligjit që ka qenë në procedurë të miratimit, por për shkak të ndërprerjes së punës së Kuvendit ngeli i papërfunduar dhe i pamiratur në dëgjimin e dytë.

Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, të cilin sot po e shqyrtojmë, është hartuar duke u bazuar në standardet e Bashkimit Evropian dhe është në harmoni me konventat përkatëse dhe direktivën 2002/49 EC për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis dhe është i hartuar sipas teknikave të reja juridike që sigurojnë zbatim të lehtësuar të ligjit brenda sistemit juridik të Republikës së Kosovës.

Projektligji përbëhet prej nëntë kapitujve dhe ka gjithsejtë 31 nene.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese, si dhe për zbatimin e tij nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore.

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi i qasjes unike me synim të shmangies, parandalimit dhe zvogëlimit të efekteve të dëmshme, duke përfshirë bezdisjen për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës në mjedis.

Me këtë projektligj synohet zbatimi më i lehtë i tij nëpërmjet definimit të përgjegjësive të qarta të institucioneve përkatëse, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal, me theks të veçantë në definimin e detyrave dhe përgjegjësive të qarta të komunave në zbatimin e këtij ligji, gjë që nuk ka qenë e rasti me ligjin në fuqi.

Ky projektligj gjithashtu synon të ofrojë bazë për mobilizimin më substancial të komunitetit përkitazi me zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha të ndotjes akustike, në veçanti automjetet e transportit rrugor, hekurudhor dhe infrastruktura, transporti ajror, pajisjet e jashtme, ato të industrisë dhe makineria mobile.

Projektligji për mbrojtjen nga zhurma shtjellon detajisht rregullat dhe kushtet për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe planin e veprimit, mënyrën e informimit të publikut dhe përgatitjen e raportit për zhurmën.

Projektligji përfshin edhe shtojcat në të cilat janë të paraqitur indikatorët e zhurmës, metodat e vlerësimit për indikatorët e zhurmës, metodat e vlerësimit për efektet e dëmshme dhe kërkesat minimale për përgatitjen e hartës strategjike të zhurmës dhe planit të veprimit.

Më lejoni që në fund të fjalës sime ta vë një theks të veçantë në nenin 6, paragrafin 2 të projektligjit, i cili rregullon se për cilat burime të zërit nuk vlejné dispozitat e këtij ligji dhe konkretisht ndërmjet të tjerave përfshirë zhurmat që prodhohen nga individët, nga fqinjët, zhurma në hapësirat ushtarake dhe nënparagrafin 6 definohet qartë se ky projektligj nuk e rregullon dhe nuk e mbikëqyrë drejtpërdrejt zërimin e kambanave dhe pajisjeve elektroakustike në kohën e rriteve fetare. E dini se kjo ka qenë një temë e debatit të madh publik shumë herë edhe me tone të papranueshme dhe shumë herë i panevojshëm. Dua të theksoj se kjo dispozitë ligjore, pra neni 6, paragrafi 2, nënpika 6, është në pajtueshmëri të plotë me nenin 2, paragrafin 2 të direktivës evropiane 2002/49 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës të datës 25 qershor 2002 për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore. Pra, kemi të bëjmë me një tranfuzim të drejtpërdrejtë të kësaj directive në ligjin tonë edhe në këtë aspekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tash do ta dëgjojmë mendimin e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući,

Poštovani ministre,

Uvaženi kolege poslanici,

Poštovani građani,

Parlamentarna komisija za poljoprivredu, prostorno planiranje i zaštitu životne sredine je razmotrila u celosti Vladin predlog, odnosno prvo čitanje Nacrta zakona o zaštiti od buke i članovi Komisije su mišljenja da se Zakon danas razmatra u parlamentu, tako da ćemo do drugog čitanja imati dovoljno vremena da u okviru Zakona uputimo sve preporuke, izmene i dopune koji će Parlament doneti a ispunjavaju sve kriterijume koje Evropska Zajednica institucionalno zahteva od nas a sama činjenica da se ovaj Zakon ne odnosi na verske institucije jer olakšavajući za sve nesuglasice ovog zakona, koje su u prošlom sazivu parlamenta naišle na nerazumevanje, kako os strane poslanika, tako i od građana.

Još jednom ponavljam, Parlamentarna komisija za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i ambijent podržaće Vladin predlog Nacrta zakona o zaštiti od buke.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas rregullit, ftojme kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për PDK-në, kush e ka fjalën? Deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëndetje zoti ministër,

Zonja Rexhepi foli edhe në emër të grupit, kështu që ne e mbështetim çfarë tha zonja Emilija Rexhepi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj. Siç e tha edhe ministri, ky projektligj e ka një histori qysh nga mandati i kaluar me ç'rast janë zhvilluar shumë debate dhe ka pasur amendamente të shumta për ta plotësuar dhe ndryshuar atë. Tash ka ardhur një version të themi tjetër, pak i ndryshëm nga ai i mandatit të kaluar.

Komisioni nuk ka hyrë në debat lidhur me ndryshimin para se të vijë në lexim të parë, meqë ka qenë i interesuar që t'i dëgjojë opinionet e deputetëve dhe ndryshimet dhe plotësimet të dalin nga debati që do të bëhet këtu.

Edhe grupi parlamentar po ashtu ka vlerësuar se ky draft mund të vijë në lexim të parë, pavarësisht faktit që ka nevojë për ndërhyrje dhe ndryshime.

Disa çështje esenciale të këtij projektligji nuk janë sqaruar sa duhet. Esenca e këtij projektligji është limitimi i zhurmës, vlerësimi, definimi i saj dhe limitimi. Pra, përcaktimi i nivelit të zhurmës së lejuar, e cila në fakt, edhe pse është esenca e këtij projektligji, nuk është definuar në projektligj. Është thënë që do të rregullohet me një akt nënligjor nga ministri, por unë mendoj që kjo është e gabueshme, sepse nuk mund ta lëmë një çështje kaq të rëndësishme në dorën e vetëm një ministri, meqë është një çështje që ka rëndësi të madhe për mbrojtjen e ambientit në Kosovë.

Ne në debat, gjatë procesit të amendamentimit, do ta shohim se cila është mënyra për ta zgjidhur këtë, a do ta përcaktojmë ne në ligj limitin e zhurmës, apo do ta autorizojmë Qeverinë që ta bëjë këtë.

Mendoj se zgjidhja më e mirë është që vetë Parlamenti ta bëjë limitimin e zhurmës në mënyrë që ligji pastaj të ketë një mundësi të zbatimit më të madh, sepse nëse e lëmë që ministri ta bëjë këtë, sot është një ministër edhe mund ta bëjë një nivel të lejueshëm, nesër vjen një ministër tjetër dhe mund ta ndryshojë këtë, ose vetë ministri i tashëm në rrethana të caktuara mund të bëjë ndryshime, kështu që nuk e shoh shumë serioze këtë mënyrë të rregullimit të zhurmës së lejuar.

Edhe disa aspekte tjera që kanë qenë shumë të ndjeshme dhe janë debatuar shumë në projektligjin e mandatit të kaluar: mendoj se sërish do të ridebatohen, besoj që do të gjejmë zgjidhje të arsyeshme për të gjitha çështjet që janë shtruar aty.

Pra, Grupi Parlamentar në parim e përkrah këtë projektligj dhe në procedurat e mëtutjeshme ne do të jemi aktivë në plotësimin dhe ndryshimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj! Emilija Rexhepi u paraqit, a je si përfaqësuese, a si deputete?

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

I u ime Parlamentarne grupe PDK-a.

Parlamentarna grupa PDK-a razmotrila novi Nacrt zakona od buke koji je na zahtev Vlade dostavljen Komisiji za poljoprivredu, i ako smo u prošlom sazivu parlamenta imali oštru raspravu pojedinih poslanika, gde su bila potrebna određena objašnjenja i izmene, i sa izradom novog zakona koga danas imamo na razmatranje jasno se definišu odgovornost institucija za sprovođenja ovog Zakona gde decidno stoji odgovornosti opštine, odnosno svih indikatori buke i njihovo sprovođenje kao i metode za procenjivanje. Ovaj Zakon je u skladu sa direktivom Evropske zajednice broj 2002/49, te njegov opšti cilj utvrđivanje jedinstvenog pristupa u cilju izbegavanja, sprečavanja i ismejavanja štetnih efekata, uključujući stvaranje baze uvođenja mera koju emituju veliki izvori buke, posebno drumska transportna vozila, železnička vozila i njihova infrastruktura, vazdušni saobraćaj, spoljašnja oprema industrije i pokretna mašinerija.

Član 5 ovog Zakona govori da zaštita od buke i obezbeđenje sprovođenja ovog Zakona je zadatak centralnih, ali lokalni institucija, pravnih i fizičkih lica i građana, a odgovorni organi nadležni za zaštitu od buke u životnoj sredini su Ministarstvo za ambijent, odnosno Departman za zaštitu životne sredine, Kosovska agencija za zaštitu životne sredine, zatim opštine, ili lokalne samouprave, preko svoj inspektorata.

Buka je deo politike Evropske zajednice da bi postigli visok nivo ljudskog zdravlja i zaštite životne sredine. Jedan od ciljeva koji treba slediti za usklađivanje Zakona sa direktivom za ocenjivanje i upravljanje bukom u životnoj sredini je zaštita dozvoljenog nivoa buke imajući u obzir da buka je upućena od Evropske komisije kao jedan od glavnih problema životne sredine.

Shodno tome, poslanici Parlamentarne grupe PDK-a će danas podržati ovaj Zakon. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+” Mufera Shinik.

MÜFERRA ŞİNİK: Faleminderit, kryesues!

Görültüden Korunma Yasa Tasarısını geçen Meclis döneminde geçiremediğimiz bu yasa tasarısını bu dönemde en iyi bir şekilde geçmesi için çabamızı sunacağız.

Önemli olan geçen dönemde Yasa Tasarısından çekemediğimiz dini objelerin dini kaynağı olarak sayılması paragrafını kaldırabildik. Yani yasadan çekmeyi başarabildik.

Onun dıřında “6+” Parlamento Grubu olarak birinci okunuřunu kabul etmekteyiz, ikinci okunuřuna kadar yasanın en iyi bir řekilde gemesi iin komisyonlarda abamızı sunacaėız. Teřekkr ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjaln.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti nnkryetar!

Prshndetje koleg deputet, ministr,

Qllimi i ktij projektligji sht kodifikimi apo vendosja e standardeve n fushn e ambientit ose mbrojtjes nga burimet e mundshme apo burimet kryesore t cilat e prodhojn zhurmn.

Ambienti i till dhe ekspozimi n kto ambiente pr njerzit n zhurma t ndryshme pa dyshim q sjell rrezikun dhe dmtimin e shndetit t njerzve, q e dini secili prej jush.

Prandaj, sht me shum rndsi q n kto ambiente ku njerzit jetojn, ku njerzit banojn, ku njerzit lvizin, ku njerzit punojn, pra si jan ambientet rrugore, mbrojtja nga zhurma n rrug, ambientet apo institucionet e ndryshme, qofshin ato arsimore, ambientet apo institucionet, apo shtpit private, institucionet publike, ambienti publik, institucionet fetare, industria e gjithka tjetr pra q prfshihet ktu sht mir q t vendosen mbi parimet e atyre standardeve, t cilat i duhen kohs dhe jan t nevojshme q t vendosen n kt projektligji.

Nj prej shtjeve tjera q duhet dhe pa dyshim q jemi shum mbrapa sht ajo q kemi par edhe m hert, por s’kemi pasur shum interesim ta dgjojm n Parlament kur kemi t bjm me standardet, vendosjen e standardeve, implementimin e standardeve, zbatimin e standardeve, n t gjitha veprimtarit e jets n Kosov. Pra, ne jemi larg, e ky sht nj dm i madh pr shoqrin ton q s’po prgatitemi, s’po promovojm, por s’po t jemi t guximshm t’i vendosim realisht ato standarde q i duhen kohs, por si duket po i shmangemi pak ose n pjes t mir ktyre standardeve, edhe pse po i qndisim me fjal t mira ktu n Parlament, por mendoj q kjo nuk i duhet ktij projektligji.

Prandaj, un jam pr variantin q limitet e niveleve t zhurms, prve edukimit qytetar, sht dika tjetr, e cila i duhet ksaj shoqrie, na duhet n shkolla ku do tjetr, sepse e kemi mangsi kt sfer. Ne na duhet pra t’i vendosim lirit dhe nivelet e zhurms, sepse nuk po sillemi mir. Ne e keqprdorim kt shoqri, e keqprdorim ambientin, e keqprdorim shtpin, e keqprdorim restorantin, i keqprdorim institucionet fetare, i keqprdorim institucionet universitare, i keqprdorim t gjitha dhe i tejkalojm jasht mase dhe nuk sillemi asnjri prej nesh n pajtim me standardet q duhet t jen brenda ktyre institucioneve.

Prandaj, jemi t detyruar dhe un mendoj q duhet t’u prmbahemi ktyre kriterëve dhe niveleve t ktyre limiteve.

Standardet flasin dika tjetr, ato thon q brenda 24 orve pr do qytetar q jeton n nj vend, n nj shtet, kudo tjetr, ose punon, ose lviz n komunikim normal nuk duhet t jet zhurma m e madhe se 60 decibel. Kjo mund t vlej edhe pr mua q jam duke folur tash, se mund t’i kaloj 60 decibel. Pra, duhet t jemi korrekt q t shohim se ka po vendosim n standarde.

Tjetra? Zhurma në institucione apo në veprimtari të ndryshme, pavarësisht se cilat janë ato, qysh e kanë emrin, a janë arsimore, a janë industriale, a janë fetare a çka janë, të mos brengosmi që ta trajtojmë temën me themel siç duhet, jo ta ngremë zërin e ta trajtojmë ndryshe siç ka ndodhur herën e kaluar në Parlament, se ajo nuk i bën nder askujt. Pra, është më e vogël se 80 decibelë, le të urdhërojnë standardin ta ndërtojmë për krejt institucionet. Nuk është me rëndësi cilat janë. Duhet të jetë pra në hapësirën publike ku unë jetoj, ku ju jetoni, ku fëmijët tanë jetojnë, ku të gjithë jetojmë nën 80 decibelë, a është mëngjes, a është mbrëmje, a është në shkollë a në universitet, ne duhet t'i përmbahemi kësaj, duhet ta vendosim në ligj.

Ambientet ku flemë, gjumin ku e bëjmë, nëse duam të flemë, të jetojmë më gjatë, të jetojmë më shëndetshëm, të jetojmë më mirë, ne duhet të mendojmë, nuk duhet të jetë mbi 55 decibelë. Ky është standardi i Evropës, ky është standardi global i botës, s'është veç i Evropës, por është edhe në Turqi, edhe në Arabi. Kjo është edhe gjithkund tjetër, se jemi mësuar me këtë modelin tjetër që t'i nënvlerësojmë ato, se edhe ata bëjnë gjumë si ne, edhe ata janë njerëz si ne.

Prandaj, duhet të kemi kod të definuar, ndërsa zhurma mbi 85 decibelë është e papranueshme në çdo ambient, e të mos flasim kur i kalon 100 e 120, që është vdekjeprurëse me dëmet shumë të mëdha për njerëzit, e atëherë çka është thirrja?

Ky ligj nga kjo që dëgjuam këtu, nga mënyra që si u tha këtu unë personalisht mendoj që nuk i ka këto kodifikime, i munda këto. Prandaj, është i mangët, pra ne duhet të jemi korrektë si deputetë, si ministra, kur ta marrim një detyrë ta kryejmë me ndërgjegje të plotë, jo t'i shmangemi dhe të bëjmë interpretime të cilat nuk janë aspak në pajtim. Jemi mësuar ne këtu në Kuvend të flasim 'kjo është në pajtim me Bashkësinë Evropiane, kjo është në pajtim kështu' pa qenë fare, pa e lexua hiç, ja standardi ku është, këto janë normat.

Prandaj, unë si deputet do dëshiroja e do t'i ftoja gjithë deputetët, në mënyrë të veçantë Komisionin Funkcional që pa asnjë zhurmë të urdhërojë, le t'i vendosë standardet brenda ligjit, e jo ta lënë në mëshirën e Fatmir Rexhepit si ministër. Unë ngrihem një mëngjes një ditë, e më rrok mua sikleti, dhe ja futi, them 'bën ashtu, bën kështu', e se nuk e shkruaj udhëzimin hiç. Nuk bënë ashtu! Nuk jemi ne ende të formuar, ende s'e kemi atë nivel dhe ende e kemi pabesinë e madhe që këto gjëra do të renditen dhe të vendosen me standarde ashtu qysh i duhen shoqërisë.

Prandaj, ne si parlamentar ta themi drejt, ta vendosim drejt, ta vlerësojmë drejt dhe të mos bëjmë shmangie. Unë jam për variantin që të vendoset në projektligj. Komisioni Funkcional e ka për obligim t'i vendosë në projektligj të gjitha nivelet e limitet të cilat janë të lejueshme me standarde. T'i lexojmë mirë, vendosni mirë për të gjitha institucionet. Nëse doni ta bëni një ligj të mirë. Nëse duam të bëjmë hajgare dhe të bëjmë qysh kemi bërë probleme edhe në mandatin e kaluar, atëherë është muhabet tjetër.

Prandaj, unë dua të jem i rezervuar. Ky draft që është afruar këtu nuk i plotëson këto kritere, nuk i ka këto limite, nuk i ka këto nivele. Do të jem i rezervuar në votim, do të jem neutral. Në rastin tjetër, në qoftë se nuk futen këto, unë do ta kundërshtoj. Por pres dhe kam besim te deputetët, edhe te ata që janë përgjegjës, që ta bëjnë interpretimin drejtë, t'i vendosin kriteret e limitet në pajtim me standardet të cilat u thanë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë kam qenë pjesë e Komisionit për Bujqësi, kryetar kam qenë dhe e kemi pasur mandatin e kaluar Ligjin për zhurmën dhe e kemi amendamentuar projektligjin. Kemi qenë edhe në vizitë nëpër bashkësitë fetare, kemi qenë në Bashkësinë Islame, Kishën Katolike, Kisha Ortodokse nuk na ka pranuar dhe kemi qenë në vizitë në Turqi në Këshillin e Bashkësisë Islame, në Këshillin për të Drejtat e Njeriut, atje te ombudspersoni. Kemi qenë edhe në Patrikanën e Stambollit dhe në të gjitha këto vizitat që i kemi bërë kemi qenë me qëllim më të mirë që ta gjejmë një gjendje më të mirë për zërimin nëpër xhamia, apo në pjesë të bashkësive fetare.

Në sugjerimet dhe këshillat dhe vendimet që i kemi marrë dhe i kemi si model që Kosova me përqindje të madhe të besimit islam i ka marrë modelët e Turqisë që të jetë me limitet kohore të zërimin në akustikë me decibel, në këshillin e lartë të Bashkësisë Islame e kemi takuar kryetarin e tyre, që është ministër i fesë në Turqi, dhe ai thotë ne i kemi limitet e caktuara për mëngjesin, për ditën dhe për mbrëmjen.

Mëngjesi ishte diku 45 decibelë, që është një normë e lejuar që të mos e pengojë askënd dhe duke fjetur. Ndërsa dita ishte 65 decibelë, ndërsa mbrëmja ishte me 55 decibelë, kjo do të thotë që është e lejueshme si normë.

Prandaj, ne kur e kemi kërkuar këtë, kemi kërkuar që jo të gjitha rregullat e Bashkimit Evropian ose direktivat e Bashkimit Evropian janë të arsyeshme edhe për vendin tonë.

Për ne është me rëndësi që ta kemi një Ligj për zhurmën, ta kemi një ligj që i kontrollon pajisjet akustike dhe këto pajisje akustike edhe kur janë nëpër objekte fetare, edhe kur janë nëpër deponi, apo punëtori të ndryshme, është masa e lejuar të cilën e ka si kriter.

Kriteri që ne kemi kërkuar të jetë i kontrolluar, zërimi edhe nëpër bashkësitë fetare, edhe për këtë kemi pasur takim me kryetarin e Bashkësisë Islame, Naim Tërnavë, edhe aty ata kanë llogaritur që e kanë një rregullore të brendshme dhe ajo rregullore e brendshme e tyre tregon pikërisht për punën që edhe aty e kanë limitet e zërimin, numrin në decibel. Kur kemi qenë në vizitë te ta ka qenë zërimi ose ezani i lijuar me decibel në 65-70. Kjo do të thotë që kur kemi shkuar ne si komision, çdo gjë ka qenë e kontrolluar, por kur kemi dalë nga aty zërimi ka qenë i tejkaluar nga masat derisa ka shkuar edhe në momentet e rokut, që është një gjë e rëndë.

Për ne që e kemi bërë projektligjin, i kemi edhe amendamentet e propozuara, të gjitha amendamentet, ligji ka mbetur pa u miratuar vetëm pse kemi shkuar në zgjedhje, do të thotë që ligji është i përfunduar dhe pikërisht për çështjet e Bashkësisë Fetare i kemi edhe amendamentet ku i kemi kërkuar që kjo të zgjidhet me anë të ligjit, një nga variantet, dhe varianti i dytë ka qenë që ministri me udhëzimet apo me aktet nënligjore, që do të jetë pjesë e Qeverisë, që Qeveria t'i miratojë aktet nënligjore, që ta rregullojë zërimin nëpër objektet fetare. Kjo do të thotë që rregullimi i zërimin nëpër objektet fetare t'i kalojë Qeverisë si objekt, ose si institucion më i lartë në raport me ministrin, dhe mundësia e ndryshimit ose plotësimit është më e vështirë. Prandaj, edhe zbatueshmëria do të jetë më e qëndrueshme.

Për ne dhe për mua personalisht në këtë projektligj që ka ardhur me ato pjesë pa ndryshuar në disa pjesë, por megjithatë unë besoj që komisioni dhe ne këtu, atë që e tha deputeti Fatmiri është e arsyeshme që t'i plotësojmë, se jo çdo direktivë është ajo që na obligon. Neve na obligon nevoja për një shëndet më të mirë të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Tani që po e marr fjalën, e pashë se sa deputetët po presin të flasin për këtë projektligj dhe është edhe një pas meje.

Të jeni të sigurt se po të ishte ndonjë temë që ka të bëjë me shitjen e patriotizmit do të ishin shumë më shumë, por nuk është e tillë - është temë që secili deputet duhet të mbajë qëndrim, në qoftë se duam ta ndërtojmë një shtet ligjor dhe demokratik.

Unë për vete do ta them këtë qëndrim dhe qëndrimi im personal në lidhje me këtë projektligj prej fillimit dua ta them se është i papajtueshëm për disa pika, të cilat do t'i trajtoj më poshtë.

Projektligji për zhurmën po na vjen në duar për herë të dytë, një herë në mandatin e kaluar dhe tani edhe në këtë mandat për herë të tretë, në fakt tani për herë të dytë. Kjo po ndodh jo sepse kemi të bëjmë me ndonjë ligj shumë të komplikuar që ne nuk po dimë t'ia lidhim kryet, siç thotë populli, po për shkak të oportunizmit edhe injorancës.

Shumë deputetë kanë shkuar në mandatin e kaluar, kanë bërë edhe udhëtime nëpër botë për ta marrë eksperiencën se si e kanë të rregulluar vendet e tjera çështjen e zhurmave, edhe pse ne të gjitha ligjet që i prodhojmë i prodhojmë në përputhje me 'acquis communautaire' me ligjet e Bashkimit Evropian dhe aty janë standardet. Imagjinoni tani sikur për çdo projektligj deputetët të kërkonin që të udhëtonin në botë për t'i parë eksperiencat, mendoj që do të falimentonte edhe shteti nga harxhimet.

Dështimi i miratimit të këtij projektligjit dy herët e kaluara ka ndodhur për shkak të politizimit të një çështjeje, e cila s'do duhej të ishte fare çështje në lidhje me lartësinë e zërit të objekteve fetare, konkretisht nivelit të decibelëve të lejuar për xhamitë dhe për kishat, më saktë për xhamitë.

Deputetët e mandatit të kaluar në fakt i janë nënshtruar linçimit publik të grupeve obskurantiste fetare, të cilët bënin zhurmë me arsyetimin se ezani nuk është zhurmë, se kjo qenka fyerje e ndjenjave të besimtarëve. Edhe muzika e Moxartit apo e Bethovenit në rast se do t'i kalonte nivelin e decibelëve, ju garantoj se do të bëhej e padurueshme. Unë personalisht dua të denoncoj publikisht përdorimin e linçimit publik si mjet apo metodë për të arritur qëllimet politike që po përdoret gjithnjë e më shpesh në Kosovë, që është përdorur edhe në rastin e Projektligjit për zhurmat.

Linçimi publik në perceptimin tim është i barabartë me dhunën fizike. Në rastin konkret për ligjin duket qartë se Qeveria është dorëzuar para zërave obskurantist, them Qeveria sepse ky projektligj përpara se të vijë në Kuvend është miratuar nga Qeveria, mua fare nuk më intereson

nëse ky projektligj është sjellë nga ministri Agani, i cili me sa di unë deri vonë punën e zhurmave e ka pasur prioritet të ministrisë, shpresoj ta kesh ndryshuar zoti ministër se Kosova është vendi më i ndotur në Evropë edhe në aspektin akustik, por edhe në aspektin e ndotjes në përgjithësi.

Mandatin e kaluar, pra u hodh baltë mbi deputetët që votuan duke u fshehur e vërteta se Projektligji për zhurmat sanksiononte si zhurmë një nivel të caktuar të decibelëve që zakonisht arrihet vetëm me zmadhuesit elektronik të zërit e jo me zërin origjinal. Për të gjithë ata që nuk e kanë marrë vesh akoma, bota ka evoluar nuk është më as në shekullin e parë e as në shekullin e shtatë, kambanat e kishave apo ezani që dikur shërbenin për t'iu treguar njerëzve kohën sot nuk e kanë më një funksion të tillë, besoj e dini, sot janë thjeshtë pjesë e identitetit të feve përkatëse, e meqë bota ka ecur përpara, të nderuar deputetë, ne jetojmë në kohë moderne e shtete demokratike, ku duhet të respektohen të drejtat e të gjithë qytetarëve, si të atyre që besojnë edhe të atyre që nuk besojnë, si të një feje, ashtu edhe të një feje tjetër.

Është shteti, pra ai që duhet të ndërhyjë, të vendos disiplinë e harmoni ndërmjet të gjithë komuniteteve që jetojnë në një shoqëri të caktuar. Ja pse shteti duhet të vendosë kritere edhe për lartësinë e zërave që lëshohen në ambient, qofshin ato edhe nga objektet fetare. Përgjithësisht që ka ndodhur në këtë projektligj, në nenin 6 dhe në nenin 9, është për mendimin tim dorëzim pa kushte përpara linçimit, është mosnjohje e shtetit laik të sanksionuar në Kushtetutën e Kosovës dhe mbi të gjitha është abuzim me vetë liritë fetare të garantuara po në këtë Kushtetutë.

Unë ju pyes ju, të nderuar deputetë, që kaq lehtë i nënshtroheni retorikës së grupeve ekstremiste. Çfarë do të kishit bërë ju nëse do të kishit qenë në dorën tuaj përcaktimi i karakterit laik të shtetit të Kosovës? Nga mënyra se si u sollën deputetët në mandatin e kaluar, por në të gjithë vitet e fundit unë dyshoj shumë se ju do t'ia jepnit këtë karakter. A e dini se me këtë projektligj ia keni kaluar, zoti ministër, edhe vetë Arabisë Saudite dhe të gjitha vendeve islamike, të cilat i sanksionojnë objektet fetare që nuk respektojnë kufizimet e lartësisë së zërit. A e dini që edhe në Arabinë Saudite nuk mund të lëshohet zëri nga disa xhami njëkohësisht siç ndodh në Kosovë ku distanca fizike mes tyre është e afërt, sepse përveçse disharmonisë kjo shndërrohet në një problem për fëmijët, të sëmurët, pleqtë etj.

A e dini se në çdo vend perëndimorë kambanat e kishave i nënshtrohen kufizimeve strikte të sanksionuara me ligj, mbi të gjitha a i keni pyetur votuesit tuaj nëse ndotja akustike që vjen nga objektet fetare, të cilat janë të shpërndara pa kurrfarë plani urbanistik po i shqetëson ata. Unë ju rekomandoj t'i pyesni në fakt kjo vlen për të gjithë deputetët dhe do shihni që numri i votuesve që janë pro sanksionimit është jashtëzakonisht më i madh se numri i atyre që janë kundër, sepse njerëzit thjesht duan të jetojnë të qetë dhe pa zhurma.

Unë ju rekomandoj që të mos u nënshtroheni linçimeve obskurantiste, të mos tregohemi frikacakë si deputetë, por ta bëjmë ligjin ashtu si duhet brenda normave, një ligj që i trajton të gjithë si të barabartë, një ligj që i respekton liritë fetare të të gjithëve. Unë personalisht do të jap kontributin tim me amendamentimin e së paku dy neneve e ndoshta ka nevojë më shumë, zoti Fatmir Rexhepi foli në mënyrë shumë më të detajuar në lidhje me problemet që ka ligji, por një gjë mund ta them me siguri nga ajo që kam parë që ligji nuk është në përputhje me ligjet që janë

në Bashkimin Evropian, nuk është në përputhje me atë, sepse nuk bën Bashkimi Evropian përjashtime të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Me sa e di unë ne jemi në legjislaturën e pestë dhe në vitin 2016 dhe kemi për herë të parë shqyrtimin e Projektligjit për zhurmën, por fatkeqësisht po më befason degradimi i debatit nga disa kolegë deputetë ngase janë duke e shqyrtuar Projektligjin e vitit 2014.

Shumë mirë ministri në këtë projektligj ka cekur burimet e zhurmës dhe shumë mirë janë të definuara, ndërsa disa deputetë fatkeqësisht vuajnë ende nga ajo pse ministri nuk e ka cekur se qenka edhe ezani burim i zhurmës. Është shumë e papranueshme për neve që të themi se ezani është burim i zhurmës, është fyese për shumicën absolute myslimane që jeton në Kosovë edhe për respektin e veçantë dhe për bashkësitë e tjera fetare edhe për kampanat e kishës. Është e papranueshme prej Kuvendit të Kosovës që ezani cilësohet si burim i zhurmës dhe të rregullohet me decibel.

Edhe deputeti Rexhepi, edhe deputeti Hasani e përmendi këtë edhe parafolësja tjetër. Deputeti Hasani e përmendi një përvojë shumë të mirë nga mandati i kaluar kur ka qenë kryetar i Komisionit për Bujqësi dhe ka udhëhequr at komision vizita të ndryshme, një ndër to në vizitën edhe Republikën e Turqisë, por harroi ta përmendi një të vërtetë të madhe deputeti Hasani, nuk e tregoi se atje çështja e ezanit nuk është e rregulluar përmes Projektligjit për zhurma, atje nuk e kanë fut te zhurmat ezanin. Prandaj, çështja e ezanit edhe të kampanave të kishës nëse duhet të rregullohet, duhet të rregullohet me një rregullore të brendshme nga bashkësitë fetare, edhe nga Bashkësia Islame, edhe nga Bashkësia Katolike dhe të tjera, e jo të krijojmë precedentë këtu që Qeveria të ndërhyjë në jetën fetare të qytetarëve të Kosovës.

Më herët parafolësi e përmendi edhe se Qeveria duhet ta rregullojë këtë, që Qeveria të ndërhyjë në institucionet fetare në Kosovë. Unë mendoj që duhet të jemi më largpamës. Kosova ka një pasuri të madhe ngase ka një tolerancë të shkëlqyer ndër fetare, nuk guxojmë në asnjë moment që ndonjë deputetë për bindjet e tij personale të brendshme ta rrënojë këtë tolerancë ndër fetare, mos luani me tolerancën e qytetarëve të Kosovës. Ju e dini mandatin e kaluar se si është polarizuar situata pikërisht për këtë projektligj.

Armend, kur të vijë radha flasim unë e ti. Gjithë flitni, kur të vijë radha flasim bashkë unë e ti, e mos të dhemb se shumë mirë e dëgjova me vëmendje sa as nuk e pata në plan të flas, por e patë çka biseduat.

KRYESUESI: Vazhdoji idetë tua, Kelmendi!

GËZIM KELMENDI: Kështu që është shumë e papranueshme të polarizohet situata, i dëgjova shumë mirë fjalimet e parafolësve të mi se as nuk pata në plan të flas, se ngase unë e vlerësova pozitivisht këtë projektligj që ka ardhur nga ministri dhe nuk dëshirova fare të kyçem në debat, por të kërkohet, unë e dëgjova tekstualisht për hir të korrektësisë Armend po ta kujtoj se ndoshta

s'ke qenë këtu, deputeti Rexhepi tha: "Duhet të rregullohet me decibel në sabah dhe duhet të rregullohet me decibel në aksham" kush duhet të rregullohet në sabah dhe në aksham, kush për kë po flet, për ezanin.

Deputeti Hasani e përmendi konkretisht ezanin, do të thotë për ezanin po flasin këtu apo e sheh Armend që e ki humb orientimin, unë shqip jam ka flas dhe shqip dëgjova dhe është e papranueshme të cilësohet si ezani burim i zhurmës, ne jemi duke debatuar për Projektligjin për zhurmat dhe është e papranueshme ezani dhe kambanat të futen te Projektligji për zhurma, kjo duhet të rregullohet me rregulloret e brendshme. Mos e polarizoni situatën për interesa të juaja personale, mos e prishini tolerancën ndërfetare. Ky popull e ka një pasur edhe atë duhet ta ruajmë, prej kur tash kjo legjislaturë e fundit merr guximin dhe thirret në emër kinse të Bashkësisë Evropiane. Nëse keni dal në Bashkësinë Evropiane urdhëro shikoni se si është e rregulluar atje, kam qenë me dhjetëra herë dhe e di si është e rregulluar atje, kështu që mos flisni në emër të Bashkësisë Evropiane.

Prandaj, edhe njëherë e përgëzoj ministrin për këtë projektligj dhe është e papranueshme se ezani të futet në këtë projektligj si burim i zhurmës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, një minutë e ke. Nait, mos e zgjat, një minutë, shkurt! Nait Hasani, replikë!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Dëshiroj t'ia bëj me dije kolegut deputet, Këshilli i Bashkësisë Fetare Islame në Turqi, në Ankara është ministri në vete, është këshill i lartë i shtetit i cili i rregullon çështjet fetare në Turqi.

Ata e kanë sinkronizimin, i kanë decibelët për ezanin. Ata tekstualisht na kanë thënë mund të bërtitni sa të mundeni, por nuk duhet ta pengoni asnjërin. Mund ta thirrni ezanin sa të doni, por nuk duhet t'i pengoni të gjithë të tjerët bashkësitë fetare që janë atje. Prandaj, ata e kanë me ligj e tjetër është, unë këto i thash ato që na kanë thënë atje janë raportet i kemi të komisionit, mund t'i shfletoni dhe t'i shihni, por megjithatë nuk e kemi ta mashtrojmë askënd. Turqia e ka të rregulluar me ligj plus e ka të sinkronizuar, mëngjesin e ka 45, ditën e ka 65 me 70, edhe 55 e ka mbrëmjen për një jetë të shëndetshme në Turqi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Së pari nënkryetar unë kërkoj falje që ndërhyra pa mikrofon gjatë fjalimit të kolegut tim deputet. Mirë, a përfundove? Unë ndërhyra me zë sa ishte duke diskutuar kolegu im deputet, për këtë arsye e mora fjalën, sepse unë e dëgjova edhe ministrin, e dëgjova edhe përfaqësuesin tim të grupit parlamentar, i dëgjova edhe të gjithë kolegët tjerë deputetë.

Ajo çka më pengoi mua ishte fjala e tij në kundërshtim të plotë me atë çka diskutuan edhe ministri, edhe çka diskutuan edhe të gjithë deputetët tjerë, kjo ishte edhe arsyeja pse e ngrita zërin. Asnjë qëllim, as përmbajtje e drejtë e tij është...

KRYESUESI: Ajo është e drejtë e tij zotëri, pikëpamjet e tij janë...

ARMEND ZEMAJ: Po e drejtë e tij nuk është që t'i keqpërdorë fjalimet e të tjerëve në kuadër të një çështje, e cila është sensitive edhe e ka kaluar Kuvendi i kaluar. Domethënë, kjo ishte edhe arsyeja ime pse ndërhyra pa asnjë qëllim, as për përmbajtje, as për gjuhë, por as për diskutime tjera.

Edhe prapë po i them tash edhe përmes mikrofonit, po i them që nuk është në ...të askujt që të jepet kah tjetër asnjë diskutimi, mbi të gjitha t'i jepet kah e cila mund të ngrit debate të panevojshme që nuk i kontribuojnë as këtij ligji, po as shoqërisë në përgjithësi, kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Fundi i fundit, unë do t'jua jap edhe një herë fjalën. Zoti Gëzim e merr fjalën, po mos e humbni kohën për gjëra që keni mendime të ndryshme, sepse nuk do ta bindni njëri-tjetrin. I shprehët mendimet, mos na humbni kohë që ta bindni njëri-tjetrin, nëse i keni bindje ju i mbani. Gëzim Kelmendi, një minutë!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Jo, pa dyshim nuk e kam në plan ta bind askënd. Liria e shprehjes dhe të menduarit është e garantuar në këtë vend. Ajo çka dëshiroj të ndërlihem ishte në fjalimin e deputetit Hasani që shumë mirë e ceku se si është e rregulluar jeta, organizimi i jetës fetare në Turqi dhe ashtu si është atje edhe unë kërkoja do të thotë të jetë me Rregullore jo me ligj dhe një pyetje ia bëra direkt, por mungoi përgjigjja.

Prapëseprapë do të thotë at pyetjen që e bëra po e përsëris prapë, a është e rregulluar çështja e rregullimit të ezanit në Turqi me Ligjin për zhurma? Nuk është! Edhe kjo është fyese për ne të jetë e rregulluar këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! O, Nait kurrigjë s'je duke sqaruar, tri herë e ke thënë sot. Nait, gjysmë minute e ke!

NAIT HASANI: Mjafton edhe disa sekonda kur thuhet qëllimi, qëllimi është që komisioni në Turqi nuk ka shkuar për fabrika që të shikojë çfarë zhurme kanë atje. Komisioni ka shkuar në Turqi pikërisht për ezanin edhe ka shkuar në Këshillin e Bashkësisë Islame, këshillin e lartë atje.

Prandaj, këto të dhëna janë të këshillit të bashkësisë, ata e kanë me ligj.

KRYESUESI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë jam pjesë jo aktive për Ligjin në mandatin e kaluar, por kështu në mënyrë pasive, por tani do të jam pjesë aktive për këtë ligj, sepse jam edhe në komision ku do të aplikohet.

Megjithatë, kur do të përgatitet ne do të kemi mundësi që në leximin e dytë të përjashtojmë kërkesa, mendime, meqenëse edhe ne si anëtarë të komisionit kemi vërejtjet e tona lidhur me

ligjin dhe unë mendoj që zhurma vetë në vetvete si nocion është si rregullsi e cila rrjedh nga rregullsia e pakontrolluar. Dhe, në fizikë ose fizikanët, por edhe në mjekësi zhurma përdoret edhe në forma tjera si shëruese, por edhe si dëmtuese, serioze prandaj, titulli i ligjit ndoshta duhet të shihet ose të ndërrohet komplet si titull. Dhe ne nuk kemi nevojë të ligjërojmë ose të institucionalizojmë ndoshta edhe emra nga terminologjia jonë në gjuhën shqipe që është ta shndërrojmë si zhurmë.

Nga aspekti i përdorimit të zërave unë jam dakord që me udhëzimet administrative, të cilat do të bëhen të mundshme mbi bazën e ligjit të përcaktohen shkallë nga aspekti shëndetësor i lejimit qoftë të objekteve ushtarake siç tha edhe është në nen atje, sepse edhe pavarësisht pse është objekt ushtarak nuk ka të drejtën permanente të prodhojë zhurmë pse është ushtri. Ka të drejtë vetëm në kushte të jashtëzakonshme ose në format e alarmit të cilat janë dhe për ato rregullohet me sipërfaqen, me gjatësinë valore të zërit, me frekuencën e zërit që shndërrohet me decibel.

Prandaj, nuk ka nevojë që sikur herën e kaluar ta politizojmë at çështje që shteti po ndalon fenë ose feja nuk është e toleruar nga shteti. Që të dy grupet kanë spekulime mendoj dhe shteti jonë është qartësisht i orientuar në të drejtën e përdorimit fetar, mirëpo jo edhe në keqpërdorimin fetar për interesa të ndryshme.

Në leximin e dytë keni mundësi çdo deputetë i cili ka pasur vërejtje këtu në seancë të vini në komision, të japim propozime. Për njohuri të juaja ne, unë personalisht posedoj materialet edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe në Kanada, në Evropë, në shtetet veç e veç, në Bashkimin Evropian si është i vendosur me ligj të cilat do të mundohemi që t'i aplikojmë. Dhe këto janë adresat gjeografike që ne do shohim për të aplikuar ligjin. Adresat tjera gjeografike që janë për tu kthyer ndryshe ku feja drejton e shtetin unë mendoj që asnjë deputetë këtu nuk do ta bëjë, por edhe shteti nuk është i interesuar ta dëmtojë fenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit! Unë shumë shkurtimisht do t'i them dy-tri fjalë, besoj se të gjithë deputetët këtu e dinë, por jo veç deputetët por të gjithë qytetarët e Kosovës se ne nuk jemi këtu as Turqi, nuk jemi as Arabi. Jemi Kosovë, jemi pjesë e Evropës pavarësisht që politikisht s'na kanë pranuar ende si pjesë të Evropës, por gjeografikisht, historikisht, pjesë e civilizimit jemi si pjesë e civilizimit evropian edhe kjo nuk ka asnjë dilemë dhe nuk mund të diskutohet, domethënë rreth kësaj, nuk mund të vihet në dilemë kjo çështje.

Duke qenë kështu, natyrisht unë mendoj që një nga vlerat shumë të rëndësishme të Evropës është edhe respektimi i aspekteve fetare, i besimit fetar të secilit individ dhe të secilit kolektivitet, kështu që nuk kemi ne asnjë arsye që ta politizojmë këtë çështje, sepse secili duhet të respektojë domethënë edhe këto çështje. Unë pajtohem shumë me kolegun që tha që ndoshta nuk është mirë që të quhet ky ligj për zhurmën, sepse disi po e ka at konotacionin negativ, zhurmë në gjuhën shqipe nuk e di edhe gjuhët tjera qysh tingëllon, por është njëfarë tingëllimi jo i mirë, njëfarë tingëllimi që tërheq menjëherë negativitet.

Domethënë, zhurmë, mos bo zhurmë, pse po bën zhurmë. Është diçka gjithmonë negative. Ndoshta është mirë pak që ta ndërrojmë këtë terminologji dhe t'i japim një konotacion tjetër.

Përndryshe, ju lutem shumë, pa politizim në qoftë se kërkohet që ezani, por edhe kambanat të jenë në harmoni me standardet kjo nuk është prishje e harmonisë fetare dhe ju lutem shumë mos bëri blasfemi këtu me çështjet fetare. Nëse kërkojmë që këto të jenë në harmoni me standardet ndërkombëtare, zërimi pra, jo zhurma zërimi ose zëri, nuk nënkupton kjo prishjen e harmonisë fetare, përkundrazi nënkupton respektimin e standardeve, edhe evropiane, apo mbi të gjitha evropiane, pjesë e së cilës jemi dhe në harmoni me ligjet e së cilës ne punojmë dhe veprojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedavajući!

Ja u samom startu napomenuh da i u prošlom sazivu parlamenta kada je bio Nacrt zakona o buci, imali ovakve nesuglasice između nas poslanika, i sada ponovo imamo i to se politizuje i prosto je neverovatno da poslanici nisu u dovoljnoj meri pročitali ovaj Nacrt zakona koji definitivno isključuje verske objekte u ovom Nacrtu zakona.

Znači, verski objekti ne mogu biti svrstani u izvoru buke i oni nisu svrstani u ovom zakonu i ne znamo u čemu uopšte danas se raspravlja. Učenje zna ne može biti nikad biti izvor buke, crkvena zvona i katolička zvona nisu u izbor buke i ovaj Zakon je isključivo se ne odnosi na verske objekte, i ne znamo o čemu danas se dana uopšte raspravlja kada se uopšte u Nacrtu zakona ne stoje verski objekti kao izvori buke .Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë, ministri e ka fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për këtë debat, ndonëse shumë qartë po shihet se është ka zhvillohet ende nën hijen e debateve paraprake të viteve të kaluara, mendoj që ligjin që e keni para jush udhëzon diçka krejt tjetër, është një realitet krejt tjetër, është një realitet evropian i qasjes ndaj këtij problemi dhe unë uroj që kështu ta vazhdojmë punën rreth këtij.

Përfundimisht dua të sqaroj edhe deputeti Rexhepi, edhe deputetët tjerë që patën dilema lidhur me atë se a rregullon ky ligj çështjet përkitazi me intensitetin e zhurmës në mënyrë detaje apo i lihet ministrit që ta përcaktojë nivele e tjerë, e tjerë. Sikur të lexohet ligji me kujdes e shihni se i ka gjashtë shtojca që në detaje i përcaktojnë këto nivelet e zhurmës që lejohen, si monitorohen, si vlerësohen dhe si menaxhohen.

Andaj, në këtë aspekt nuk ka kurrfarë dileme. E dyta, në qoftë se ka pasur ndonjë dorëzim që u përmend një dorëzim para qarqeve kësi e asi, në qoftë se ka pas dorëzim para standardeve evropiane, absolut. Direktiva, unë po flas me fakte, argumente në qoftë se ka argumente tjera kam dëshirë që t'i dëgjoj. Direktiva 2002-49 e Komisionit Evropian. Neni 2, paragrafi 1 rregullon çka konsiderohet zhurmë mjedisore në këtë ligj, paragrafi 2, i neni 2 çka nuk konsiderohet.

Vlerësimi i ekspertëve dhe Ministrisë së Integritetit Evropiane që i ka krahasuar dispozitat e ligjit tonë me dispozitat e direktivës evropiane është se ka përputhshmëri të plotë në këtë aspekt.

Prandaj, këtu nuk kemi problem. Mendoj se e kemi një dokument të mirë ligjor, nuk është dokument ligjor i punuar për së shpejti, për së nguti është dokument ligjor që i ka shfrytëzuar përvojën e një debati të ashpër publik, e thashë në fillim të fjalës time, vizitave studimore, shumë ballafaqimeve të mendimeve dhe mendoj që është një akt i mirë ligjor i cili natyrisht në fazën e ardhshme të punës në komision mund edhe të sofistikohet edhe më tutje, por mendoj që jemi në drejtim të mirë dhe uroj që ky ligj ta kryej funksionin themelor që e ka, e kjo është të mbrojë shëndetin publik të qytetarëve.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! U krye diskutimi, një minutë Alma!

ALMA LAMA: Meqë iu referua ministri fjalës sime. Unë kam dy pyetje për ministrin, i nderuar ministër tek neni 6 pika 2.6 thuhet, po e citoj: “nga zërimi i kambanave, e keni shkruar edhe gabim, dhe pajisjeve elektroakustike në kohën e rriteve fetare”, pra këto përjashtohen.

Pse keni përmend vetëm kambanat këtu? S’keni thënë objektet fetare në përgjithësi, pra. Dhe çështja është pse e keni përjashtuar këtë e diskutova unë dhe jeni dorëzuar dhe marrëveshja ose kompromisi që ju keni bërë me linçimin publik është neni 9, pika 3 ku thuhet: “vlerat kufitare të zhurmës në varësi të llojit të burimit të zhurmës, kohën dhe vendin e përcakton ministri me akt nënligjor”. Pse duhet ta përcaktojë ministri me akt nënligjor, por nuk duhet ta përcaktoj ligji, sepse akti nënligjor është i një niveli më të ulët se sa vetë ligji, apo jo. Këtu është çështja, këtu është ai kompromisi dhe dorëzimi përpara linçimit publik i deputetëve, kurse ju e di që e keni kështu domethënë premtim elektorale.

KRYESUESI: Urdhëro, ministër! Ministër, veç përmbledhu se jemi në fund.

MINISTRI FERID AGANI: Përgjigjja ime zonja Lama është direktiva evropiane. Përgjigjja ime gjithmonë, për çfarëdo lloji përkitazi me këtë temë është direktiva evropiane.

Neni që thotë se përfundimisht ministri ka të drejtë në situata të caktuara për të mos nxjerr ligje çdo herë të përcaktojë vlera kufitare, në situata të caktuara. Ky ligj, shikoni, ky ligj edhe njëherë po e them po e humb po më duket po e humbin esencën. Ky ligj është i transpozuar prej direktivës evropiane 2002/49. Nuk mund të flasim për një nen me e nxjerr prej tërësisë.

Ky ligj i joni është i vlerësuar se është në masën më të madhe në pajtim me këtë direktivë. Të jeni të bindur me këtë, sado që kjo na pëlqen ose nuk na pëlqen, por jemi të përkushtuar të inkorporojmë standarde evropiane në praktikën tona ligjore.

KRYESUESI: Fatmir Rexhepi. Fatmir, në formë pyetjesh mundesh...

FATMIR REXHEPI: Jo, unë veç një fjali. Megjithatë, pa hy në interpretimet që i thanë kolegët që ma përmendën emrin mua, është çështje e tyre. Unë edhe njëherë po them që për shkak të interesimit të jashtëzakonshëm, edhe për shkak të interesimit të jashtëzakonshëm edhe për shkak të interesit të veçantë që e ka projektligji edhe mos t’ia japim asnjë keqkuptim se nuk kemi detyrë ta nxjerrim në kontekst të saj diçka tjetër, unë po e them edhe njëherë që ne e kemi për obligim të kodifikojmë në kuadër këtij projektligji, në mënyrë të veçantë komisionit përkatës,

relevant t'i merr parasysh edhe t'i vendos të gjitha limitet dhe nivelet, të cilat kanë të bëjnë pra me burimet kryesore, të cilat i krijojnë zhurmën ose ngritin shqetësime publike, pavarësisht në cilin institucion janë.

Asnjëherë nuk specifikohen nuk do t'i them, por unë po them se duhet, sepse këto janë standarde ku jeton shoqëria sot, në këtë shoqëri bashkëkohore ku ka ndryshuar jeta duhet ta kuptojmë dhe t'i bëjmë këto ndryshime dhe plotësime në pajtim me këtë. Mos të kapemi tash mes vete, të gjuhem me fjalë se nuk bën, as nuk e bëj atë s'do ta bëj asnjëherë. Prandaj, unë edhe njëherë po e them e kemi për detyrë që ta bëjmë në pajtim me ato norma, standarde për të cilat ne i kemi bërë qysh thonë "gojën plotë". Kështu që duhet të vendosen në kuadër të ligjit, kemi vendosur edhe të tjera, por edhe këto duhet të plotësohen në kuadër të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, unë do të kisha dalë atje po s'mund ta lë foltoren se jam vetëm dhe ndjej nevojë t'i them dy-tre fjalë.

U tha disa herë edhe me referime që ky është një ligj që ka kaluar nëpër diskutime të tilla, bile shumë edhe më të gjata herën tjetër dhe për sa dëgjova së paku nga referencat tuaja ndërrime nuk ka të veçanta, pak a shumë është ajo materie me një përjashtim një ose dy. Çështja është pse nuk bëhemi më konkretë kur e dimë që e kemi një ligj, të cilin duhet ta kodifikojmë dhe çdo kodifikim bëhet nëpërmjet amendamenteve. Ne mund të flasim në pikëpamje individuale dhe ndjesi individuale për problemet që kodifikohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo i lejohet çdo individ dhe çdo deputeti.

Por, nuk mund të emocionohemi deri në nivelin që të mos e dëgjojmë logjikën e njëri-tjetrit. E dyta, këto tipa diskutimesh s'kanë, prandaj nëse nuk bëhen amendamente nuk kanë vlerë, por janë njerëzit thonë "a më dëgjove çka thashë", por ajo faktikisht nuk ka pasojë. Pasoja bëhet në ligj, atëherë meqë unë po hetoj që problemi është edhe në emërimin e ligjit, po a nuk mundet ministri edhe Qeveria ta quajë këtë ligj, po e zëmë "Ligji për mbrojtjet nga lartësia e zërave" pasi qenka problem i madh me thënë zhurmë, që s'po i themi zhurmë.

Lartësia e padurueshme për njeriun në vende të banuara e zërave, edhe e harrojmë atëherë se metafora e keqkuptuar anulohet, ose s'po duam ta bëjmë këtë sepse ne po flasim edhe për ligje fizike edhe për ligje... zëra fizike, unë tash po i quaj "metafizike" tash, se kemi të bëjmë me praktikume dhe lutje.

Atëherë, a s'po mundka të bëhet edhe në këtë ligj një amendamentim i tipit ku thotë: "në lutjet ose praktikimet fetare lartësia e zërit..." edhe tani nëse na duhet ta shenjtërojmë edhe gjuhën tonë "lartësia e zërit", "... e harmonisë së kampanoreve" edhe po e zëmë "... e melodisë së zërit" ka mbërri deri në kaq decibelë. Edhe, kënaqen edhe ata që duan ta shenjtërojnë gjuhën edhe ata, që me e bë fizikë edhe metafizikë. Unë nuk thash që ju do ta bëni këtë tip, qysh e thash unë, unë po shoh që problemet janë pak edhe të shpifura, sepse ka mundësi. Kaq sa për problemin e zhurmës edhe që s'bën me i thënë "zhurmë" asnjë fjale që është lutje. U krye, unë s'kam mendim tjetër.

Herën tjetër e kam thënë, po e përsëris, edhe Simfonia 9 e Bethovenit, nëse lëshohet me lartësinë që të shurdhon, ti thua kjo s'vlen gjë.

Tash po kalojmë te puna e ministrit, po atëherë bëjeni ju, ju deputetë jeni, Kuvendi mund ta kthejë krejt ligjin se lëre më ta bëjë një amendament. Po, me një amendament që në strukturën e ligjit të caktohen ky e ky problem dhe mos t'i lehet as këtij ministri, as atij nesër. Kaq. Faleminderit!

Unë ju them që brenda janë 63 deputetë, ju thërras që të votojmë për, kundër ose abstenim, por të votojmë, të marrim pjesë në votim për leximin e parë të Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma. Me këtë titull deri në këtë moment, votojmë tash!

Unë edhe njëherë ju tregoj, 54 veta, 63 jeni, bile këso kartele jeni 79, dikush edhe lë kartelë por s'është këtu, po ato po i lëmë. Fizikisht janë të numëruar që jeni 63 vetë. Unë ju kisha thirrur edhe një herë... Është punë e juaja çfarë bëni, por edhe një herë ju them, harroni pra diskutimet e flakta që i bërë, se janë "nyl", nëse s'merrni qëndrim çfarë të doni: për, kundër, e tjera..., se kjo është metodë që s'funksionon. Unë ju thërras edhe një herë, prekeni njërën prej tri varianteve. Edhe kësaj radhe ju thërras, votoni tash.

Sipas interpretimeve të famshme të Gjykatës Kushtetuese përcaktimi në votim numërohet në bazë të asaj që thuhet. Me kartelë... sa jeni ... ky ligj i ka marrë, kanë votuar 59 vetë, i ka marrë 51 votë për, 1 e ka kundër, 7 i ka abstenim. Ky është rezultati.

Kalojmë në ligjin tjetër. Konstatim s'kam, unë e thashë rezultatin, konstatoni vetë. S'kam unë konstatim. Kalojmë në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ju thërras, ka votime, votime ka këtu.

E ftoj deputetin Agim Ademaj, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, i cili projektligj rregullon procedurat që agjencia përkatëse duhet të ndjek më rastin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë nga organi kompetent, në këtë rast gjykata.

Komisioni i ligjeve dhe grupi punues gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ka ardhur në përfundim, se projektligji është hartuar mirë dhe i njëjti me 33 nene të tij të përmbledhura në nëntë kapituj mbulon të gjitha segmentet e kësaj fusheKal, duke i mundësuar agjencisë administrim efikas të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar. Gjatë punës së komisionit në

amendamentimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë shoqëria civile, OSB-ja, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe të agjencisë. Komisioni më rastin e shqyrtimit të këtij projektligji ka nxjerrë 9 amendamente, prej të cilave 5 janë amendamente që rregullojnë çështje teknike dhe gjuhësore, ndërsa 4 amendamente janë më thelbësore, që do të ndikojnë që ky ligj të jetë më praktik dhe më funksional në arritjen e qëllimit të tij.

Në emër të Komisionit të Ligjeve falënderoj të gjithë aktorët që kanë dhënë kontributin e tyre, në mënyrë që ky projektligj të marrë formën finale përmes amendamenteve. Ndërsa, juve kolegë ju ftoj që këtë projektligj ta votoni me amendamentet që janë propozuar nga Komisioni i Ligjeve. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Kalojmë në votim të amendamenteve nga numri 1.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Ma jep edhe një herë numrin, edhe një herë! Erdhi edhe një. Atëherë, ju lutem shumë përgatituni për votim bashkë me amendamentet e Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 58 kanë votuar për dhe 3 kanë abstenuar. Kuvendi e miratoi Ligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të skemës së ndihmës sociale, për periudhën 2013-2015

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë mbikëqyrjen buxhetore të skemës së ndihmës sociale për periudhën 2013 – 2015 dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime. Ftoj deputetin Fikrim Damka, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ka bërë mbikëqyrjen e buxhetit të skemës së ndihmës sociale për periudhën 2013-2015, ku në mbledhjen e mbajtur më 09.3.2016 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohen rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të skemës së ndihmës sociale për periudhën 2014-2015, si në vijim:

- Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtyre rekomandimeve, si vijon:

1. Zbatimi i legjislacionit

Rekomandohet zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore gjatë procesit të aplikimit të aprovimit për zgjedhjet si dhe pagesave;

2. Bashkëpunimi ndërinstitutional

Rekomandohet të përmirësohet niveli i bashkëpunimit në mes të komunave dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale, që të ketë nivel më të këndshëm të menaxhimit të skemës për ndihmë sociale;

3. Personi dhe kushtet e punës

Rekomandohet plotësimi i nevojave dhe kushteve për punë, pasi që vetë natyra e shërbimit të dhënë nënkupton shumë vizita në terren për verifikimin e familjeve në nevojë.

4. Funksionimi i softuerit

Të përmirësohet puna e softuerit, siguria si dhe lehtësimi i kryerjes së procedurave, që do ta bëjë më të lehtë menaxhimin e vëllimit të madh të lëndëve. Të funksionalizohet softueri me kolona të mjaftueshme për vendosje të të dhënave të nevojshme për familjet që aplikojnë.

5. Transparenca dhe publikimi i raporteve

Të rritet transparenca nga Ministria sa u përket shpenzimeve të buxhetit, të publikohen raporte dhe informata për qasje nga publiku në bazë të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Ligji për procedurën përmbartimore

Ndihmat nga skema sociale janë të rrezikuara nga Ligji për procedurën përmbartimore, që nga aprovimi i këtij ligji një numër i konsiderueshëm i familjeve në skemën e ndihmës sociale janë ankuar dhe janë bllokuar, tërhequr mjetet financiare të ndihmës sociale. Të adresohet ky problem me institucionet përkatëse si Ministria, Ministria e Drejtësisë si dhe Oda e përmbartuesve privatë në eliminimin e këtij problemi.

7. Respektimi i kriterëve për dhënien e ndihmës sociale

Rekomandohet ngritja e nivelit të kontrollit dhe përgjegjësisë, ndëshkimi i punëtorëve të cilët në vazhdimësi aprovojnë familje, që s'e meritojnë të jenë përfitues të skemës.

8. Përfituesit e mjeteve në mënyrë të kundërligjshme

Rekomandohet që të zhvillohen procedurat e nevojshme dhe të kërkohet që të gjitha familjet që kanë fituar në mënyrë të kundërligjshme, të kthejnë mjetet në harmoni me dispozitat ligjore.

9. Decentralizimi i shërbimeve

Përgatitja e një analize apo hulumtimi i hollësishëm, sa u përket ndryshimeve të Ligjit për skemën sociale, si dhe bartjes apo delegimit të kompetencave në nivelin lokal. Analiza apo hulumtim me orientim krahasues lidhur me menaxhimin, llogaridhënien dhe përgjegjësinë, sa i përket menaxhimit të skemës sociale, shqyrtimi i mundësisë së rikthimit të QPS-së nën menaxhimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale.

10. Mekanizmi i kontrollit

Rekomandohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht nisja e kontrollit dhe mbikëqyrjes që vepron në kuadër të Departamentit për politika sociale të familjes, të ushtrojë mandatin e saj - dispozitat ligjore.

11. Shuma e përfituesve për familje dhe person

Rekomandohet shqyrtimi i mundësisë së rritjes së shumës së vlerës për skemën e ndihmës sociale sipas rritjes së kostos së shportës familjare. Pra, të rritet shuma e pagesës në proporcion me shumën e shportës së ushqimeve dhe rritjen e inflacionit. Të shqyrtohet mundësia e shumës apo vlerës, siç parashihet me standarde të organizatave ndërkombëtare për familjet skamnore apo familjet përfituese të skemës së ndihmës sociale, që shuma apo vlera ditore të jetë 1,5 euro në ditë për person.

12. Vështirësi në kompletimin e dokumentacionit në aplikim

Rekomandohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht komuna, të shikojë mundësinë e ofrimit të ndihmës në kompletimin e dokumentacionit, në mënyrë që të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këtë ndihmë, ta kenë mundësinë e përfitimit.

13. Niveli i ulët i përgjegjësisë së drejtorëve të DKSHM-së

Rekomandohet që drejtori i DKSHM-së të adresojë rekomandimet te personat përgjegjës në QPS në raport me përzgjedhjen apo refuzimin e familjeve në kundërshtim me dispozitat ligjore.

14. Tërheqja e mjeteve në banka - Institucioni financiar i kontraktuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale

Të bëhet shqyrtimi i mundësisë që tërheqjet e mjeteve, varësisht se në cilën bankë familja apo përfituesit e kanë më afër. Të obligohen bankat që t'u shërbejnë qytetarëve pa diskriminim. Shqyrtimi i mundësisë së shpërndarjes së numrit apo familjeve të përfituesve nëpër secilën bankë, varësisht prej fuqisë apo shtrirjes së tyre nëpër komuna.

15. Ngritja e kapacitetit të stafit

Rekomandohet që të bëhet identifikimi dhe organizimi i trajnimeve të nevojshme të stafit të QPS-së për ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, lidhur me përzgjedhjen e familjeve përfituese të skemës për ndihmën sociale; trajnime dhe teknologji informative; legjislacioni; vlerësimi i ekonomive familjare; sjellja e tyre në terren; e të tjera...

Unë besoj se deputetët do ta votojnë këtë raport, të cilin e kemi punuar për 2013 – 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Kalojmë në diskutimet për grupet parlamentare. Janë dy të paraqitur, Flora Brovina dhe Salihe Mustafa, flasin në emër të vet apo të partisë, grupit... Urdhëro! Flora Brovina e ka fjalën, për PDK-në.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Deputetët e Partisë Demokratike në kuadër të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë dhënë kontributin e tyre për nxjerrjen e këtij raporti dhe të rekomandimeve. Andaj, ne insistojmë që ky raport të aprovohet njëzëri nga deputetët dhe në favor të atyre që kanë nevojë për ndihma sociale. Me këto rekomandime do të përmirësoheshin dukshëm mundësitë, që përfituesit të kenë lehtësira në përfitimin e ndihmave sociale, të udhëzohen në përfitim, por edhe punëtorët që merren me këto çështje të avancohen dhe të jenë punëtorë më adekuatë në sistemin e mbrojtjes sociale.

Dihet sa e nevojshme është kjo çështje dhe sa serioze, që të merremi me te, kur në Kosovë është numër i lartë i atyre që marrin ndihma sociale dhe këto ndihma janë tepër të ulëta, prandaj korrigjimi i dobësive dhe gabimeve në këtë sistem do të mundësonte rritjen e këtyre ndihmave. Derisa në Kosovë aktualisht ndihma sociale janë 0.5 euro për person, që ka nevojë për ndihmë sociale, dihet se varfëria e skajshme numërohet 1 euro në ditë për person. Pra, edhe dyfishimi i këtyre ndihmave duke kursyer dhe duke punuar, duke zbatuar ligjin, nuk do të mundësonte përmirësim, por sigurisht që gabimet dhe kursimet e mëtutjeshme dhe dënimi i atyre që keqpërdorin këtë fond mundësojnë që të plotësohet rekomandimi i 11-të, pra shuma e përfituesve të skemës sociale të jetë më e lartë dhe të jetë në kuadër të standardeve.

Lus kolegët që t'i aprovojnë këto rekomandime në favor të kategorisë më të ndjeshme të popullatës sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Flora Brovina! Për Grupin e LDK-së kush flet? Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë raport. Normalisht, se ne që kemi qenë pjesë e grupit punuese bashkërisht edhe me kolegun Hatim Baxhakun, kemi dhënë kontributin tonë lidhur me rekomandimet. Mirëpo, konsiderojmë edhe ne si grup parlamentar, që ky raport normalisht të votohet dhe ta ketë parasysh ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'i zbatojë rekomandimet, çka mendoj se është shumë e nevojshme për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për periudhën 2013-2015, mirëpo njëherësh është që të rritet transparenca ndaj buxhetit, sepse mendoj se kemi obligim ndaj qytetarëve, posaçërisht ndaj kësaj kategorie, që të lehtësojmë procedurat e njëkohësisht të jemi më vigjilentë ndaj përfituesve, se kush janë dhe kush duhet të përfitojë në këtë skemë të ndihmës sociale.

Unë mendoj se në qendrat për punë sociale duhet të ketë ngritje të kapaciteteve të punonjësve socialë, por njëherësh edhe të raportimeve të buxhetit në ueb-faqen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë që të dihet se kush janë përfituesit dhe si menaxhohet paraaja publike, në këtë rast të skemës së ndihmës sociale.

Faleminderit për vëmendjen dhe ftoj kolegët deputetë që ta votojnë këtë raport me rekomandime të Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë një punë të mirë, ka realizuar monitorimin e buxhetit të skemës sociale për arsye se me decentralizimin e këtyre shërbimeve ka paqartësi dhe probleme në komuna. Duke qenë e informuar me problemet që kanë qendrat e punës sociale nëpër komuna, rekomandimi numër 3 i këtij raporti është i domosdoshëm që të përmbushet. Fjala është për plotësimin e nevojave të kushteve të punës kryesisht për shtimin e numrit të veturave, duke pasur parasysh natyrën e punës së qendrave për punë sociale.

Unë i përkrah rekomandimet e dala nga ky raport i Komisionit për Shëndetësi, por kërkoj që të shtohet edhe një rekomandim shtesë, i cili do të ishte: Të obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që në periudhën prej gjashtë muajsh të raportojë në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale, se sa janë përfillur rekomandimet e dhëna nga komisioni dhe të votuara, besoj sot nga Kuvendi, për secilën komunë, sepse llogaridhënia rritë performancën e punës. Përndryshe, këto rekomandime të mira do të mbeten vetëm në letër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të respektuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Në radhë të parë, para se ta them atë që po mendoj të them, unë do të shfrytëzoj nga rasti që të falënderoj komisionin, ose grupin që ka punuar në këtë raport dhe i ka nxjerrë këto rekomandime. Sigurisht, që këtu po vërehet se është bërë një punë serioze dhe ajo që mendoj është shumë për të ardhur keq, me krejt këto rekomandime, diku 15 rekomandime që i ka nxjerrë ky grup, faktikisht lirisht mund ta shtrojmë një pyetje të thjeshtë, se vërtet gjatë kësaj periudhe kohore a ka funksionuar kjo ministri dhe a ka njerëz që kanë punuar në këtë ministri. Dhe, a i nënshtrohet rregullativave ligjore që ekzistojnë në Kosovë për këtë ministri, duke filluar nga ministrat të cilët kanë qenë, nuk di se cilët ministra kanë qenë në këtë periudhë kohore, deri në ditët e sotme.

Po filloj me rekomandimin e parë, thotë: “Zbatimi i legjislacionit...”. domethënë, gjatë krejt kësaj periudhe kohore, po bie që kjo ministri ka shkelë legjislacionin në fuqi, që mendoj se është një rekomandim për tu brengosur për punën që e ka bërë deri më sot kjo ministri.

Shkojmë te rekomandimi i tretë: “Personeli dhe kushtet e punës”. Faktikisht, po del se për krejt periudhë kohore kjo ministri nuk është e kompletuar me personel të nevojshëm dhe adekuat, të cilët do ta kryenin punën gjatë këtyre detyrave që i kanë pasur obligim t’i kryejnë.

Rekomandimi i shtatë: “Respektimi i kritereve për dhënien e ndihmës sociale”. Nga kjo po del, se faktikisht kjo ministri për krejt këtë periudhë kohore i ka shkelë të gjitha këto kritere rreth ndarjes dhe dhënies së ndihmave sociale. Me këtë mund të nënkuptojmë, që ndoshta njerëzit që kanë qenë me nevojë për t’i pasur këto ndihma, faktikisht nuk kanë arritur ta realizojnë, ndërsa të tjerët, që mund të mos kenë pasur nevojë fare për këto ndihma, faktikisht kanë qenë shfrytëzues të tyre deri në ditën e sotme.

Rekomandimi tetë: “Përfituesit e mjeteve në mënyrë të kundërligjshme”, që faktikisht po lidhet me këtë rekomandimin e shtatë, edhe te rekomandimi i trembëdhjetë, niveli i ulët i përgjegjësisë së drejtorëve brenda kësaj ministrie, unë mendoj se në qoftë se këta drejtorë për krejt këto, në këtë periudhë kohore, kanë arritur që mos të tregojnë një performancë të mirë, domethënë, cila është arsyeja që edhe sot e kësaj dite janë këta drejtorë nëpër këto pozicione dhe vazhdojnë edhe më tutje t’i shkelin të gjitha ato detyra dhe obligime, të cilat kanë pasur t’i kryejnë.

Edhe rekomandimi i pesëmbëdhjetë, ngritja e kapaciteteve të stafit, që domethënë se edhe sot e kësaj dite kjo ministri nuk qenka e plotësuar konform kërkesave dhe nevojave për staf të mjaftueshëm, në mënyrë që t’i kryejë këtë punë dhe këto obligime.

Nga krejt kjo dhe nga krejt këto pesëmbëdhjetë rekomandime, që dalin nga ky raport i këtij komisioni, faktikisht në fund shtrohet vetëm një pyetje, ose mund ta shtrojmë vetëm një pyetje: A ka ministër kjo ministri apo s’ka? Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë që janë paraqitur për diskutim. Atëherë, duhet të bëhemi gati që ta votojmë këtë raport me rekomandime. Të pranishëm janë 63 deputetë. Votojmë tash!

59 vetë kanë votuar, 58 janë për dhe 1 abstenim. Shkojmë tutje!

8. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim me rekomandimet e propozuara.

Kryetari i Komisionit Funkcional, Muhamet Mustafa, e ka fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Unë nuk do të zgjas shumë arsyetimin e rekomandimeve, për arsye se ky raport, siç po e shihni, vjen me vonesë por ju lus që të aprovohen rekomandimet për arsye se kanë rëndësi që të përmirësohet situata në këtë fushë.

E para, rekomandimet kanë të bëjnë me avancimin e mënyrës së raportimit në raportet vijuese.

Nën një, ne kërkojmë që Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit duhet ta bëjë një plan të kornizës kohore të përmbylljes së procesit të privatizimit dhe likuidimin për një afat të arsyeshëm.

Zgjatja për shumë vite më tutje e procesit të privatizimit vetëm do të ndikojë në shpenzimin për administrim të fondeve të krijuara të privatizimit.

Prandaj, në një afat të arsyeshëm, të shumtën dyvjeçar, do të duhej ndoshta të përfundonte procesi i privatizimit dhe ne kemi kërkuar që Bordi dhe menaxhmenti i AKP-së ta përpilojë një plan të tillë.

E dyta. Në raportet vijuese patjetër duhet të kemi një pasqyrë më detale të monitorimit të ndërmarrjeve që janë nën mbikëqyrje dhe administrim lidhur me përmbushjen e obligimeve kontraktuese.

Disa ndërmarrje shoqërore që janë shitur, blerësit e tyre - investitorët kanë pasur për të përmbushur disa kërkesa dhe raportet vijuese duhet t'i kemi të qarta për nivelin e përmbushjes së këtyre kërkesave dhe kushteve.

E treta, një çështje shumë e rëndësishme që mbetet e pa adresuar, i rekomandojmë Qeverisë, AKP-së dhe Kuvendit që të gjejnë një zgjidhje për evitimin e imobilizimit të fondeve të privatizimit që do të thotë se këto fonde nuk duhet të ngelin të ngrira dhe të pa përdorura por të gjendet një mënyrë e përdorimit të tyre në funksion të zhvillimit ekonomik.

Prandaj, lus që t'i aprovoni këto rekomandime.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk kemi asnjë deputet të paraqitur për të diskutuar lidhur me këtë raport.

Do të pyes edhe Qeverinë, a e do fjalën?

62 deputetë janë të pranishëm.

E vë në votim raportin vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional dhe votojmë tash!

Kanë votuar 58 deputetë. 45 janë për, 4 kundër dhe 9 abstenime.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Tash kryetarja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, deputetja Jasmina Zhivković qe merr fjalën për ta arsyetuar raportin dhe rekomandimeve.

Urdhëroni zonja Zhivković!

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem se predsjedavajući!

Na osnovu člana 73. Poslovnika, Komisija za zaštitu prava i interese zajednica Skupštine Kosova, je u prethodnom periodu monitorisala 2 zakona - Zakon o selu Velika Hoča i Zakon o Istorijskom centru Prizrena.

Oba ova zakona usvojena su aprila meseca 2012. Godine. Komisija je počela monitorisanje ova 2 zakona još 2013. Godine i tek početkom 2016. Godine ima izveštaj koji može doprineti da se bolje sprovede oba ova zakona.

Bilo je potrebno 2 godine da Ministarstvo donese administrativno uputstvo koje bi olakšalo primenu i sprovođenje oba ova zakona.

Veliki deo nadležnosti odnosno veći deo nadležnosti je prenesen na lokalne vlasti u cilju sprovođenja oba ova zakona, međutim ima velikih nejasnoća oko toga kako se ovaj zakon najjasnije može sprovesti, što je Komisija naišla tokom posete na terenu i pripremila je određene preporuke koje će olakšati primenu ova 2 zakona.

Četiri godine nakon usvajanja ovih zakona stvoreni su minimalni uslovi za početak sprovođenja oba ova zakona.

Preporuke se odnose na sledeće stvari:

Prva preporuka jeste da preporučuje da Vlada Kosova u ranoj fazi pripremi plana budžeta Kosova predvidi budžetska sredstva za budžetiranje funkcionalnih Saveta sela Velika Hoča i Saveta za kulturno nasleđe Istorijskog centra Prizren za svaku fiskalnu godinu.

Druga preporuka. Preporuči se da Vlada Kosova u koordinaciji sa lokalnim samoupravama Opštine Prizren i Opštine Orahovac, u cilju davanja odgovarajućih rešenja, uvede poseban program - kod za implementaciju finansiranja funkcionalnih saveta.

I treća preporuka, je da u cilju periodičnog praćenja i nadgledanje budžeta obavezuju se saveti da jednomesečno izveštavaju Ministarstvo za prostorno planiranje o izveršenju svojih budžeta u skladu sa finansijskim pravilima izveštavanja.

To su tri osnovne preporuke za početak sprovođenja oba ova zakona i molim poslanike da uvažavaju preporuke i izglasamo ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

(Ndërprerje)

Para se të votojmë do të bëjmë një evidentim për të ditur prezencën e deputetëve në sallë.

Janë të pranishëm 62 deputetë. Faleminderit! Letrën, ma sillni pastaj këtu!

Atëherë, fjalën e ka Naiti. Urdhëro, fjalën e ka Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit nënkryetar!

Unë desha të lidhem me raportin e dy projektligjeve që i kemi për Hoçën e Madhe dhe për Qendrën Historike të Prizrenit.

Kuvendi i Kosovës e ka pasur një presion të jashtëzakonshëm kur i ka miratuar këto dy projektligje dhe rëndësia e tyre ka kaluar në një çështje marginale, apo hiç fare.

Kur e them këtë, kam parasysh se Komisioni me dy vizita na e ka prurë një raport. Një vizitë e ka bërë në Hoçë të Madhe dhe nuk ka treguar cilat janë vlerat e trashëgimisë atje që janë mbrojtur, apo janë mbrojtur, e nuk janë mbrojtur. Dhe, po ashtu, e dhe në Prizren kur e ka bërë vizitën dhe e deklaroi se kemi qenë të paqartë në vizitat tona atje.

Me çështjen e rekomandimeve rreth çështjes financiare, nuk e zgjidhin këtë problem, prandaj ky raport nuk është i plotë për mua, deri sa kemi marrë pjesë dhe kemi pasur presione ndërkombëtare drejtpërdrejt në miratimin e këtyre ligjeve.

Kur ka qenë çështja e miratimit të këtyre dy ligjeve, kemi pasur po dhe jo, me të kuqe e me të gjelbër si të votohet, ndërsa tash me një faqe kërkohet të kalojë ky raport.

Prandaj, ky raport nuk është i plotë. Ky duhet të studiohet, të analizohet dhe duhet të dilet me ato vlera të cilat i kanë kërkuar ndërkombëtarët.

Ne e kemi miratuar një Këshill atëherë dhe ai Këshill ka qenë nga 6 vetë për Hoçën e Madhe, 1 ka qenë nga komunitetet i Komunës, e po ashtu edhe në Prizren i kemi shtirë edhe bashkësitë

fetare pikërisht për të mbrojtur trashëgiminë kulturore, edhe pse e kemi shkelur Kushtetutën në këtë aspekt, sepse si shtet laik, ne e kemi bërë një këshill fetar dhe nuk janë mbrojtur këto vlera.

Prandaj, ky raport, me një vizitë nuk mund të jetë i plotë dhe kërkohet që t'i bëhet një presion nga Komisioni kuvendeve komunale dhe ta ndryshojnë këtë gjendje si duhet.

Prandaj, unë kërkoj që ky raport të mos kalojë.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Jasmina Zhivković!

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Biću vrlo kratka, jer ne želim da raširimo raspravu. Ovaj izveštaj nije napravljen na osnovu dve posete. Po ovom izveštaju, Komisija posećuje opštine od 2013. Godine, i to piše u izveštaju. Naznačeno je da do 2013. Godine Komisija redovno posećuje opštine i u više navrata je posećivala opštine zajedno sa predstavnicima međunarodne zajednice i formirani su saveti. Međutim najveći problem na koju lokalna samouprava nalazi u radu tih saveta trenutno jeste finansiranje tih saveta i ne obraćanje pažnje od strane Vlade na sprovođenje ova dva zakona.

U drugom smislu, ne vidim da izveštaj nije kompletan, što se tiče sprovođenja zakona i one odredbe koje su perđvidene zakonom.

Još jednom molim poslanike da izglasamo ove preporuke i izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, deputetët dhe teknika le të bëhen gati për ta votuar raportin me rekomandime të Komisionit për të drejta dhe interesa të komuniteteve dhe kthim për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe votojmë tash!

Atëherë, 57 deputetë kanë marrë pjesë në votim, 40 janë për, 3 kundër dhe 14 abstenime.

Kolegë të nderuar, dëgjoni pak me kujdes, edhe pse deri tash keni dëgjuar me kujdes të jashtëzakonshëm.

Me këtë pikë mbaron seanca e sotme, mirëpo e kemi një seancë të re për sot, e cila është me vetëm një pikë të rendit të ditës: 1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe me Ligjin nr. 04/L-115.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*